



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 705 Akti**

**Nr. 694 Vendimi**  
**Tiranë, më 10.8.2023**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Pamela Qirko</b>	Kryesuese
<b>Xhensila Pine</b>	Relatore
<b>Alma Faskaj</b>	Anëtare

në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Willem Brouwer, asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në datë 7.8.2023, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore lidhur me çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Bardhyl Shehu**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat e administruara dhe ato të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

i. Z. Bardhyl Shehu është subjekt rivlerësimi bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

ii. Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, z. Bardhyl Shehu i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.12.2020 me trupin gjykues të përbërë nga komisioneret Pamela Qirko, Alma Faskaj dhe Xhensila Pine (relatore).

iii. Komisioni ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

iv. Trupi gjykues, filloi hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, caktoi kryesuese komisioneren Pamela Qirko dhe deklaroi mungesën e konfliktit të interesit.

v. Trupi gjykues, vendosi pas kryerjes së hetimit administrativ me vendimin nr. 2, në datë 3.7.2023 (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Bardhyl Shehu vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit lidhur me këtë kriter, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, lidhur me kriterin e pasurisë në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe nenet 45 – 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat për marrjen e provave dhe thirrjen e dëshmitarëve dhe afatin e ushtrimit të tyre.

vi. Në datën 4.7.2023, subjektit iu dërguan rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit, duke iu caktuar afat për sjelljen e provave dhe shpjegimeve, për të provuar të kundërtën e barrës së provës deri në datën 17.7.2023.

vii. Trupi gjykues ftoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore në datën 19.7.2023, ora 13:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, Tiranë, duke i njoftuar se pas administrimit të shpjegimeve, kishte mungesë të dokumentacionit provues të përmendur në shpjegimet e tij. Ky dokumentacion u dërgua nga subjekti i rivlerësimit dhe u administrua në datën 25.7.2023.

viii. Trupi gjykues, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, vendosi të mos pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit paraqitur nga subjekti me përgjegjësit e barrës së provës për riçeljen e hetimit të dy kriterëve të tjera të rivlerësimit, atë të figurës dhe vlerësimit profesional, në kushtet kur provat për kriterin e pasurisë kishin arritur nivelin e provueshmërisë, në kuptim të nenit 4, pika 2 dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, dhe subjekti me shpjegimet e paraqitura nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës.

ix. Në datën 18.7.2023, subjekti për shkak të gjendjes jo të mirë shëndetësore kërkoi shtyrjen e seancës dëgjimore, që ishte planifikuar në datën 19.7.2023. Bashkëlidhur kërkesës, subjekti i rivlerësimit dërgoi rekomandimin e mjekes së familjes A. S. Q., e cila në rekomandim ka përshkruar se pacienti ankon për çrregullim të ekuilibrit dhe të vjella, duke rekomanduar rikontrollin e pacientit në datën 20.7.2023, si dhe raportin për paaftësi të përkohshme në punë, lëshuar nga qendra shëndetësore nr. \*\*\*, me numër regjistri \*\*\*, raport i nënshkruar elektronikisht dhe i gjeneruar nga sistemi *e-albania*.

x. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, pasi analizoi dokumentacionin e depozituar, vlerësoi se ai plotësonte kriteret ligjore të vlefshmërisë sipas rregullores nr. 2666/1, datë 21.6.2022 dhe njoftoi subjektin se pasi është njohur me dokumentacionin e dërguar, raportin për paaftësi të përkohshme, pas njoftimit të datës dhe orës së zhvillimit të seancës pranoi kërkesën për shtyrjen e seancës dëgjimore nga data 19.7.2023, ora 13:00, në datën 7.8.2023, ora 13:00.

xi. Komisioni njoftoi subjektin se ka vlerësuar shtyrjen e zhvillimit të seancës me këtë afat kohor në mënyrë që, nëse gjendja e pamundësisë shëndetësore do të vijonte, ai të kishte mundësi të merrte masa dhe të ushtronte të drejtën e marrjes së një përfaqësuesi ligjor me qëllim njohjen e tij me dosjen e rivlerësimit, si dhe shpjegimet e paraqitura pranë Komisionit në përgjigje të barrës së provës për të bërë të mundur prezencën apo përfaqësimin me mbrojtës ligjor në seancën e datës 7.8.2023, ora 13:00.

xii. Në datën 7.8.2023, para zhvillimit të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit me komunikim elektronik deklaroi se ishte në pamundësi për t'u paraqitur në seancën dëgjimore të datës 7.8.2023, duke i kërkuar Komisionit të shtyjë seancën dëgjimore për muajin tjetër, pasi gjendja shëndetësore e tij referuar diagnozës dhe, sipas mjekut specialist, kërkonte kohë që të stabilizohej. Subjekti, gjithashtu, bëri me dije se për shkak të problemeve me sistemin ende nuk i ishte dërguar raporti mjekësor dhe, sapo t'i dërgohej, do t'ia përcillte edhe Komisionit.

xiii. Subjekti pretendoi me komunikimin elektronik se ishte pajisur me raport për paaftësi të përkohshme nga data 7.8.2023 deri më 17.8.2023, por për këtë dërgoi vetëm një fotografim të

errët të ekranit të një kompjuteri, fotografim i cili u depozitua edhe dorazi në protokollin e Komisionit së bashku me kërkesën për shtyrje seance.

xiv. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, pasi administroi dhe analizoi dokumentacionin e depozituar nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik dhe në protokollin e Komisionit në datën 7.8.2023, vlerësoi se ai nuk plotësonte kriteret ligjore të vlefshmërisë sipas nenit 14 të rregullores nr. 2666/1, datë 21.6.2022.

xv. Trupi gjykues, në referim të sa më sipër, vlerësoi se subjekti deri në orën e zhvillimit të seancës dëgjimore nuk arriti të provojë me asnjë dokument ligjor me vlerë provuese gjendjen e tij shëndetësore apo edhe kërkimin e bërë Komisionit lidhur me shtyrjen e seancës.

xvi. Komisioni, duke mbajtur në konsideratë sa më sipër, vendosi të mos shtynte seancën dëgjimore, e cila u mbajt në datën e planifikuar, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

xvii. Lidhur me kërkimet e subjektit të rivlerësimit, depozituar në datën 8.8.2023, kohë kur kishte përfunduar faza e vendimmarrjes, ato janë paraqitur në një fazë procedurale, kur trupi gjykues ishte tërhequr për marrjen e vendimit përfundimtar, dhe çdo komunikim me palët kishte përfunduar dhe trupi gjykues kishte vendos mbi aktet që ishin administruar ndërkohë.

xviii. Në këto kushte, në respektim të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, kërkimet dhe dokumentacioni i depozituar nga subjekti në këtë fazë të hetimit ishin objekt i punës administrative të Komisionit, pasi në këtë fazë procedurale kur trupi gjykues kishte marrë vendimin për zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

xix. Trupi gjykues, vëren se në kushtet kur janë paraqitur një sërë raportesh mjekësore nga ana e subjektit të rivlerësimit, në fazën e fundit të procesit të rivlerësimit, momentin që subjekti duhej të përballej me konkluzionet e Komisionit në seancën dëgjimore, dukshëm ka pasur një tendencë të qëllimshme të subjektit të rivlerësimit për shtyrjen e seancave dëgjimore të caktuara, duke mos marrë asnjë masë për të realizuar të drejtën e tij të mbrojtjes në seancë.

xx. Vendimi mbi përfundimin e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Bardhyl Shehu, vetëm mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë nuk përbën në asnjë rast gjë të gjykuar për kriterin e figurës dhe atë të vlerësimit profesional.

## **I. SEANCA DËGJIMORE**

xxi. Në datën 7.8.2023, ora 13:00, u zhvillua seanca dëgjimore në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar. Subjekti i rivlerësimit nuk u paraqit në seancë, duke mos shfrytëzuar të drejtën ligjore të përfaqësimit me një përfaqësues ligjor, sikundër iu kërkua nga Komisioni.

xxii. Seanca dëgjimore u ndërpre për të vazhduar me shpalljen e vendimit të trupit gjykues në datën 10.8.2023, ora 10:10.

## **II. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

xxiii. Trupit gjykues, duke mbajtur në konsideratë sjelljen e subjektit gjatë procesit të tij të rivlerësimit, me paraqitjen e raporteve mjekësore pikërisht në ditën kur ishin caktuar seancat dëgjimore në Komision, i ka vlerësuar ato si përpjekje të subjektit për të shtyrë seancën dëgjimore dhe si përpjekje të tij për shtyrjen dhe vonesën e procesit e tij të rivlerësimit.

xxiv. Subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e tij është përpjekur të ndikojë në pengimin e punës së organeve të rivlerësimit, duke përmbushur në këtë mënyrë kushtet e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

#### **A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

xxv. ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Bardhyl Shehu, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës

së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt të rivlerësimit ka arritur në konkluzionin se:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin financiar të krijimit të pasurive;
- ka mosdeklarim të pasurisë ndër vite dhe transaksion të dyshimtë, blerje/shitje pasurie të paluajtshme;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

xxvi. Nga Komisioni, me qëllim të kryerjes së një hetimi sa më të plotë dhe të gjithanshëm, janë kryer një sërë veprimesh verifikuese hetimore për verifikimin e saktësisë së deklarimit të bërë nga ky subjekt dhe personave të lidhur me të, të dhënave të pasqyruara dhe përfundimeve të nxjerra nga kontrolli i kryer nga institucionet ndihmëse ILDKPKI, duke i krahasuar me gjetjet e Komisionit bazuar në dokumentacionin dhe provat shkresore të administruara në dosje. në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe vendimet nr. 2 dhe nr. 17 të vitit 2017 të Gjykatës Kushtetuese, nga i cili ka rezultuar si vijon:

### **Lidhur me pasuritë e ndodhura në rrugën “\*\*\*\*”**

#### **1. Apartamenti me sipërfaqe 138 m<sup>2</sup> dhe vlerë 151.440 euro, në Tiranë**

1.1. Në deklaratën *Vetting*, personi i lidhur me subjektin (bashkëshortja) ka deklaruar: “*Apartament me sip. 138 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*\*, vol. \*\*\*\*, f. \*\*\*\*, z. k. \*\*\*\*, me adresë rr. “\*\*\*\*”, pallati “\*\*\*\*”, nr. \*\*\*\*, Tiranë. Vlera: 151.440 euro*”.

**Si burim krijimi për këtë pasuri është deklaruar:** “*Në bazë të deklaratës noteriale nr. \*\*\*\*, datë 22.6.2016, shuma e parave me të cilat kam blerë apartamentin është dhënë nga 4 vëllezërit e bashkëshortit tim, Bardhyl Shehu dhe prindërit e tyre (babai), në këmbim të pasurisë objekt me sip. 16 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe toke bashkë me këtë objekt, 180 m<sup>2</sup> që ndodhet në rr. “\*\*\*\*”, aktualisht rr. “\*\*\*\*”, tek ish-serrat e \*\*\*\*, Njësia Bashkiake Nr. \*\*\*\*, Tiranë (zonë informale në proces legalizimi, pasi do ta përdorin për interesin e tyre, për pallat a për biznes, meqenëse sipërfaqja e tokës që ato kanë është e madhe, mbi 700 m<sup>2</sup>). Sa i përket aftësisë paguese, deklaroj se 2 nga vëllezërit e bashkëshortit kanë punuar prej rreth 14 vite në emigracion dhe për rreth 5 - 6 vite ka punuar dhe vëllai tjetër i tyre A. e, për pak kohë, ka punuar edhe vëllai tjetër H.. Dokument tjetër justifikues për aftësinë paguese të njërit prej vëllezërve, L. Sh., i cili në vitin 2010 ka emigruar në USA (kopje të llogarisë bankare, nr. punës, biznesit etj.)*”.

1.2 Në DPV-në e vitit 2013, personi i lidhur me subjektin (bashkëshortja) ka deklaruar: “*Apartament me sip. 138 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*\*, vol. \*\*\*\*, f. \*\*\*\*, z. k. \*\*\*\*, me adresë rr. “\*\*\*\*”, pallati “\*\*\*\*”, nr. \*\*\*\*, Tiranë. Certifikatë pasurie nr. \*\*\*\*. Vlera: 151.440 euro. Shuma e parave me të cilat kam blerë apartamentin është dhënë nga 4 vëllezërit e bashkëshortit tim, Bardhyl Shehu dhe prindërit e tyre (babai), në këmbim të pasurisë objekt me sip. 16 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe toke bashkë me këtë objekt, 180 m<sup>2</sup> që ndodhet në rr. “\*\*\*\*”, aktualisht rr. “\*\*\*\*”, tek ish-serrat e \*\*\*\**”.

1.3 Në pyetësorin standard, subjekti deklaroi lidhur me këtë apartament se: “*Në bazë të deklaratës noteriale nr. \*\*\*\*, datë 22.6.2016, shuma e parave me të cilat kam blerë apartamentin është dhënë nga 4 vëllezërit e bashkëshortit tim, Bardhyl Shehu dhe prindërit e tyre (babai), në këmbim të pasurisë objekt me sip. 16 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe toke bashkë me këtë objekt, 180 m<sup>2</sup> që ndodhet në rr. “\*\*\*\*”, aktualisht rr. “\*\*\*\*”, tek ish-serrat e \*\*\*\*, Njësia Bashkiake Nr. \*\*\*\*, Tiranë (zonë informale në proces legalizimi, pasi do ta përdorin për interesin e tyre, për pallat a për biznes, meqenëse sipërfaqja e tokës që ato kanë është e madhe, mbi 700 m<sup>2</sup>). Sa i përket aftësisë paguese, deklaroj se 2 nga vëllezërit e bashkëshortit kanë punuar prej rreth 14 vite në emigracion dhe për rreth 5 - 6 vite ka punuar dhe vëllai tjetër i tyre A., e për pak kohë ka punuar dhe vëllai tjetër H.. Dokument tjetër justifikues për aftësinë*

*paguese të njërit prej vëllezërve, L. Sh., i cili në vitin 2010 ka emigruar në USA (kopje të llogarisë bankare, nr. punës, biznesit etj.)”.*

1.4 Ka rezultuar se ky apartament është përfituar nga kontrata për kalim të drejtash datë 4.1.2011 me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., me palë A. N., pala poseduese e të drejtave, znj. E. Sh., pala përfituese e të drejtave, dhe pala sipërmarrëse A. Xh., ku është rënë dakord kalim i të gjitha të drejtave që pala e parë ka mbi apartamentin nr. \*\*\* , me sipërfaqe totale 151.44 m<sup>2</sup>, kati i 3-të, që ndërton shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në rrugën “\*\*\*\*” kundrejt shumës totale prej 151.440 euro. te pala përfituese e të drejtave, znj. E. Sh..

1.5 Sipas nenit 3 të kontratës, pala poseduese A. N. deklaron se ka marrë nga pala përfituese E. Sh. shumën e mësipërme prej 151.440 euro dhe nuk ka pretendime, duke konfirmuar pagimin e shumës prej 151.440 euro deri në datën 4.1.2011.

1.6 Dokumentacioni i përcjellë nga noteri A. M. mbi praktikën e shitblerjes së apartamentit konfirmon përfitimin e apartamentit sipas:

i) Kontratës për kalim të drejtash nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.1.2011, me palë A. N., pala poseduese e të drejtave, E. Sh., pala përfituese të drejtave.

ii) Kontratës së shitjes nr. \*\*\* , datë 31.10.2016, sipas së cilës pala blerëse E. Sh. ka blerë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. pasurinë apartament me sip. 138 m<sup>2</sup>, në godinën e ndërtuar në rrugën “\*\*\*\*”, me çmim 151.440 euro, shumë e paguar plotësisht në zbatim të kontratës së kalimit të të drejtave reale nr. \*\*\* , datë 4.1.2011 dhe vërtetimit nga shoqëria.

1.7 Në dosjen e ILDKPKI-së rezulton e administruar edhe mandat-pagesa e lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. në datën 4.10.2012, në emër të znj. E. Sh., në shumën 181.440 euro, me përshkrimin “Prenotim për apar. 151.440 euro dhe vendparkim 30.000 euro”, i cili nuk përputhet me parashikimet e kontratave për kalim të drejtash, datë 4.1.2011.

1.8 Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në përgjigjen e saj drejtuar Komisionit, sqaron se personi i lidhur me subjektin, znj. E. Sh., këtë sipërfaqe e ka përfituar nëpërmjet kontratës së kalimit të të drejtave me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.1.2011, nga z. A. N. dhe se pagesa e bërë nga znj. E. Sh. është likuiduar në emër të z. A. N. sipas nenit 3 të kontratës, ku A. N. deklaron se ka marrë shumën prej 151.44 euro dhe nuk ka pretendime.

1.9 Komisioni gjatë hetimit ka administruar edhe përgjigjen e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (në vijim ASHK), Drejtoria Vendore Tirana Jug, e cila konfirmon të regjistruar në emër të znj. E. Sh. pasurinë apartament me sip. 138 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\* , vol. \*\*\* , f. \*\*\* , z. k. \*\*\* . Në kartelën e pasurisë pasqyrohet adresa rruga “\*\*\*\*”, Tiranë, dhe shuma e paguar për apartamentin prej 151.440 euro.

## **2. Garazh me sipërfaqe 18.6 m<sup>2</sup>, vlera 30.000 euro**

2.1 Në deklaratën *Vetting*, personi i lidhur me subjektin (bashkëshortja) ka deklaruar: “*Garazh me sip. 18.6 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\* , vol. \*\*\* , f. \*\*\* , z. k. \*\*\* , me adresë rr. “\*\*\*\*”, pallati “\*\*\*\*” (nën tokë), Tiranë. Vlera: 30.000 euro, zotëron 100%*”.

**Si burim krijimi edhe për këtë pasuri është deklaruar:** “*Në bazë të deklaratës noteriale nr. \*\*\* , datë 22.6.2016, shuma e parave me të cilën është blerë garazhi është dhënë nga 4 vëllezërit e bashkëshortit tim, Bardhyl Shehu dhe prindërit e tyre (babai), në këmbim të pasurisë objekt me sip. 16 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe toke bashkë me këtë objekt 180 m<sup>2</sup>, që ndodhet në rr. “\*\*\*\*”, aktualisht rr. “\*\*\*\*”, tek ish-serrat e \*\*\* , Njësia Bashkiake Nr. \*\*\* , Tiranë (zonë informale në proces legalizimi, pasi do ta përdorin për interesin e tyre, për pallat a për biznes, meqenëse sipërfaqja e tokës që ato kanë është e madhe, mbi 700 m<sup>2</sup>). Sa i përket aftësisë paguese, deklaroj se 2 nga vëllezërit e bashkëshortit kanë punuar prej rreth 14 vite në emigracion dhe për rreth 5 – 6 vite ka punuar dhe vëllai tjetër i tyre A. e, për pak kohë, ka punuar dhe vëllai tjetër, H.. Dokument tjetër justifikues për aftësinë paguese të njërit prej vëllezërve, L. Sh., i cili në vitin 2011 ka emigruar në USA (kopje të llogarisë bankare, nr. i punës, biznesit etj.)”.*

2.2 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) çertifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 7.11.2016, për garazh me sip. 18.6 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, Tiranë, në pronësi të znj. E. Sh. + kartelë pasurie për garazh me vlerë 25.000 euro; (ii) kontratë kalimi të drejtash nr. \*\*\*, datë 4.1.2011; (iii) kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\*, datë 22.10.2010.

2.3 Në DPV-në e vitit 2013, personi i lidhur me subjektin ka deklaruar: “*Vendparkim me nr. \*\*\*, në katin e dytë nëntokë me sip. 6.12 m<sup>2</sup>. Burimi i krijimit: 4 vëllezërit e bashkëshortit për shkakun e përmendur edhe në apartament. Vlera: 25.000 euro*”.

2.4 Në pyetësin standard, subjekti ka deklaruar pronësinë për një garazh automjeti me nr. \*\*\*, me sip. 18.60 m<sup>2</sup>, sipas certifikatës së pronësisë të depozituar.

2.5 ZVRPP-ja Tiranë, me shkresën e ardhur nga ZQRPP-ja, protokolluar me nr. \*\*\*, datë 6.2.2018, konfirmon se në pronësi të znj. E. Sh. është e regjistruar pasuria me nr. \*\*\*, garazh me sip. 18.6 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, duke bashkëlidhur: (i) kartelë pasurie për garazhin me sip. 18.6 m<sup>2</sup>, regjistruar në datën 7.11.2016; (ii) kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 31.10.2016, sipas së cilës znj. E. Sh. blen nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. pasurinë garazh me sip. 18.6 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, si dhe me sipërfaqe të përbashkët në rrugën “\*\*\*\*”, me çmim 25.000 euro, shumë e paguar në zbatim të kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 8.6.2011, dhe vërtetimit lëshuar nga shoqëria për pagesën.

2.6 Gjithashtu, në dosjen e administruar në ILDKPKI, subjekti ka depozituar:

- i) Kontratë kalimi të drejtash nr. \*\*\*, datë 4.1.2011, me objekt kalimin palës përfutuese E. Sh. të të gjitha të drejtave që pala e parë A. N. ka mbi vendparkimin me nr. \*\*\*, të pallatit që ndërton pala e tretë, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., të drejta të fituara në bazë të kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.2.2010. Ndërmjet shoqërisë së ndërtimit dhe palës së parë A. N. është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 22.10.2010, që parashikon se sipërmarrësi, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., merr përsipër që në bazë të lejes së ndërtimit nr. \*\*\*, datë 19.4.2005, të ndërtojë godinë në rrugën “\*\*\*\*” dhe t’i dorëzojë porositësit A. N. vendparkimin nr. \*\*\*, për të cilin porositësi ka paguar shumën 30.000 euro + leje ndërtimi. Në kontratën për kalimin e të drejtave parashikohet se pala e parë A. N. deklaron se ka marrë nga pala e dytë E. Sh. shumën 30.000 euro. Pala e parë i ka paguar shumën 30.000 euro shoqërisë së ndërtimit dhe me nënshkrimin e kësaj kontrate do të konsiderohen të paguara nga pala e dytë. Vendparkimi do të merret menjëherë pas nënshkrimit të kontratës.
- ii) Ndërkohë, në dosjen *Vetting* është administruar edhe një kontratë sipërmarrjeje me nr. \*\*\*, datë 8.6.2011, sipas së cilës sipërmarrësi, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., merr përsipër të ndërtojë godinën në rrugën “\*\*\*\*” dhe t’i dorëzojë porositësit, znj. E. Sh., vendparkimin nr. \*\*\*, për të cilin duhet të derdhë shumën 25.000 euro + leje ndërtimi. Nga analizimi i përmbajtjes së kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 8.6.2011, rezulton se ndryshon çmimi i blerjes së garazhit, si dhe numri i pasurisë.

2.7 Noteri A. M., i cili depozitoi praktikën e shitblerjes së garazhit nga ku rezultoi: se me kontratë shitjeje me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 31.10.2016, me palë shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. (në cilësinë e shitësit) dhe znj. E. Sh. (në cilësinë e blerësit), është rënë dakord për shitjen e garazhit me sip. 18.6 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, me adresë rruga “\*\*\*\*”, pallati “\*\*\*\*”, kundrejt çmimit 25.000 euro, shumë e cila është paguar plotësisht dhe pa pretendime nga palët në zbatim të kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 8.6.2011.

2.8 Agjensia Shtetërore e Kadastrës Drejtoria Vendore Tirana Jug, e cila konfirmon të regjistruar në emër të znj. E. Sh. pasurinë garazh me sip. 18.6 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, vol.\*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*.

2.9 Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në përgjigjen e saj drejtuar Komisionit, konfirmon se personi i lidhur, znj. E. Sh., ka lidhur me shoqërinë një kontratë shitjeje me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 31.10.2016, me objekt “Shitja e vendparkimit me sip. 18.60 m<sup>2</sup>, me vlerë 25.000 euro, me

adresë rruga “\*\*\*”, Tiranë”, bazuar në kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.6.2011, duke vendosur bashkëlidhur dokumentacionin përkatës.

### **Analiza e burimit të krijimit të pasurive të ndodhura në rrugën “\*\*\*”**

2.10 Pikat 1, 2 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pika 1 e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, pika 7 e udhëzimit datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së, si dhe formulari i deklarimit të pasurisë për procesin e rivlerësimit, detyron subjektin e rivlerësimit për deklarimin e pasurive të tij dhe të personave të lidhur me burimin në momentin e krijimit të saj, ku me burim në këtë rast përfshihen mjetet financiare që kanë shërbyer për krijimin e saj.

2.11 Komisioni analizoi deklarimin e subjektit mbi burimin e krijimit të ardhurat e dhëna nga 4 vëllezërit e tij dhe babai, në këmbim të pasurisë objekt me sip. 16 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe toke bashkë me këtë objekt ndodhur në rrugën “\*\*\*”, tek ish-serrat e \*\*\*, Njësia Bashkiake Nr. \*\*\*, Tiranë.

2.12 Sa i përket aftësisë pagueuse, subjekti ka deklaruar se dy nga vëllezërit kanë punuar prej rreth 14 vite në emigracion dhe për rreth 5 - 6 vite ka punuar edhe vëllai tjetër i tyre A. e, për pak kohë, ka punuar edhe vëllai tjetër H..

2.13 Në DPV-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar: *“Në bazë të deklaratës noteriale me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.6.2016, është rënë dakord që pasuria/sipërfaqe toke prej 180 m<sup>2</sup>, si dhe një dhomë banimi me sip. 16 m<sup>2</sup>, ndërtuar mbi këtë sip. toke, që ndodhet në përfundim të rr. “\*\*\*”, aktualisht rr. “\*\*\*”, tek ish-serrat e \*\*\*, Njësia Bashkiake Nr. \*\*\*, Tiranë (zonë informale në proces legalizimi), të cilën e kam deklaruar në formularët e mëparshëm sapo të regjistrohet në ZRPP t’i kalojë në pronësi vëllezërve A. Sh., D. Sh., H. Sh. e L. Sh. dhe babait tim Xh. Sh., të cilët kanë kontribuar/dhënë paratë për blerjen e shtëpisë sime që kam aktualisht në rrugën “\*\*\*”, Tiranë (kam aplikuar për legalizimin e kësaj prone/pasurie sipas formularit përkatës datë 18.8.2006, për të cilën është lëshuar vërtetimi me nr. \*\*\* prot. nga Njësia Bashkiake Nr. \*\*\*, Tiranë, për aplikimin dhe dorëzimin e dokumentacionit). Për këtë aplikim ka dalë VKM-ja Nr. 677, datë 18.6.2009, për miratimin e kalimit të pronësisë për sip. 144.5 m<sup>2</sup> dhe sip. ndërtimi 13.9 m<sup>2</sup> në emrin tim, por nga interesimi në ALUIZNI nuk është legalizuar, pasi sipas tyre sipërfaqja ndërtimore është e vogël. Në bazë të deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 22.6.2016, është rënë dakord që kjo pasuri sapo të regjistrohet t’u kalojë në pronësi vëllezërve të mi A. Sh., D. Sh., H. Sh. e L. Sh. dhe babait tim Xh. Sh., të cilët kanë kontribuar/dhënë paratë për blerjen e shtëpisë sime që kam aktualisht në rr. “\*\*\*”, Tiranë. Për këto që deklarova disponoj formularin e vetëdeklarimit, vërtetimin nga Njësia Bashkiake dhe deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 22.6.2016. Pjesa që zotëron 0%”.*

2.14 Në DPV-në e vitit 2013, personi i lidhur me subjektin ka deklaruar: *“Apartament me sip. 138 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, me adresë rr. “\*\*\*”, pallati “\*\*\*”, nr. \*\*\* Tiranë. Vlera: 151.440 euro. Shuma e parave me të cilat kam blerë apartamentin është dhënë nga 4 vëllezërit e bashkëshortit tim, Bardhyl Shehu dhe prindërit e tyre (babai), në këmbim të pasurisë objekt me sip. 16 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe toke bashkë me këtë objekt, 180 m<sup>2</sup> që ndodhet në rr. “\*\*\*”, aktualisht rr. “\*\*\*”, tek ish-serrat e \*\*\*, Njësia Bashkiake”.*

2.15 Në DPV-në e vitit 2006, subjekti deklaron në seksionin pasuri të paluajtshme se ka përfituar si dhurim nga babai: *“180 m<sup>2</sup> tokë + 16 m<sup>2</sup> dhomë banimi tek ura e \*\*\*, e paregjistruar. Është aplikuar për regjistrim në vitin 2006”.*

2.16 Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 23.6.2016, subjekti, i pyetur në lidhje me likuiditetin cash në shkëmbim të pronës dhe se sa do ta vlerësonte pasurinë e tij të paluajtshme, tokë me sip. 150 m<sup>2</sup> dhe objekt 16 m<sup>2</sup>, është përgjigjur se: *“Nuk kam dijeni për çmimet e referencës në atë zonë. Është zonë që i përket qytetit edhe në vitin 2011 dhe jo fshatit, pra konsiderohet tokë truall. Dua të theksoj se në atë zonë janë bërë ndërtime pallatesh dhe po vijohet që edhe banesat e tjera, që e kanë hapësirën e nevojshme, t’i kthejnë në pallate. Sa i përket vlerës që është konvertuar me sipërfaqen e tokës dhe objektin, kjo shumë është vërtet e konsiderueshme, por kjo është llogaritur ose marrë në konsideratë fakti se aty do të ndërtohej*

*një pallat, meqenëse edhe sipërfaqja e tokës ishte e bollshme dhe mund të kishim përfitime të mëdha të konsiderueshme nga pallati. Në momentin që është bërë këmbimi, në këtë prizëm është trajtuar vlera e pasurisë sime. Nuk është bërë investim tjetër në atë vend, pasi sa të legalizohet aty do të ndërtohet një pallat me garazhe, dyqane dhe apartamente banimi dhe patjetër kati i parë do të shfrytëzohet për biznes, ndoshta me shumë mundësi edhe për mobilieri, ashtu si vëllezërit kanë punuar dhe e njohin këtë fushë”.*

2.17 Në dosjen *Vetting* rezulton e administruar një deklaratë e shtetasit L. Sh., i cili deklaroi se: *“Me qëllim hapjen e një biznesi i kemi kërkuar vëllait që të jap pronën e tij objektin 16 m<sup>2</sup> dhe parcelën 180 m<sup>2</sup> për të ndërtuar një biznes dhe kundrejt në vitin 2011 të gjithë së bashku i kemi dhënë Bardhylit një shumë prej 181.000 euro që përfaqëson shumën e parave të blerjes prej tij të një banese dhe garazhi në rrugën “\*\*\*” dhe vëllai ka hequr dorë nga objekti dhe parcela”.*

2.18 Gjithashtu, referuar të dhënave të ILDKPKI-së rezulton se në datën 22.6.2016 në deklaratën noteriale me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., vëllezërit dhe babai i subjektit deklarojnë se: *“Bardhyl Shehu heq dorë nga pasuria objekt 16 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe 180 m<sup>2</sup>, që ndodhet brenda parcelës prej rreth 700 m<sup>2</sup>, ku kanë ndërtuar vilën dhe, meqenëse kjo pasuri është në proces legalizimi, në momentin që do legalizohet do të kalojë menjëherë në pronësi të vëllezërve”.*

2.19 Në pyetësorin nr. 2, subjekti, i pyetur sërish në lidhje me arsyen e dhurimit të truallit dhe më pas shkëmbimit të tij, ka sqaruar se: *“Në vitin 1998, unë sapo jam martuar kam banuar në një banesë me qira të paguar nga familjarët e bashkëshortes sime, me kryefamiljar S. T., ngjitur me banesën e tyre në afërsi të Ministrisë së Jashtme Tiranë, kjo edhe për faktin se prindërit e bashkëshortes ishin të sëmurë dhe kishin nevojë për ndihmë të vazhdueshme. Ndërkohë, meqenëse unë nuk kisha interes më për të vajtur në \*\*\*, ku kisha objektin 16 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqen e tokës rreth 180 m<sup>2</sup> (ndonëse nuk kisha asnjë dokument për të), ndërkohë që babai dhe vëllezërit e mi donim të hapnim një biznes privat në fushën e prodhim dhe shitje mobiliesh, kjo edhe për faktin se dy prej tyre, A. Sh. dhe D. Sh., e njihnin zanatin e mobilierit dhe tapicerit, pasi kishin punuar për disa vite në Greqi dhe në Tiranë ose të ndërtonin një pallat. Për këtë arsye, kemi rënë dakord që prona objekti 16 m<sup>2</sup> dhe parcela e tokës në total 180 m<sup>2</sup> t’u jepen babait dhe vëllezërve të mi dhe, në këmbim të kësaj pasurie, më kanë dhënë lekët për të blerë shtëpinë dhe një garazh në rrugën “\*\*\*”, në Tiranë, shtëpi ku unë banoj aktualisht. Kështu, në vitin 2010, vëllezërit e mi, A. Sh., D. Sh., H. Sh. dhe L. Sh., së bashku, nëpërmjet babait tim, më kanë dhënë mua dhe gruas sime E. Sh., një shumë në total prej rreth 181.000 euro, të cilën gruaja ime ia ka paguar shtetasit A. N. për apartamentin dhe shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. për garazhin, në pallatin “\*\*\*”, në rrugën “\*\*\*”, Tiranë. Sipas deklaratës noteriale përkatëse, unë kam hequr dorë nga pasuria objekt 16 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqja e tokës përreth në total 180 m<sup>2</sup> tokë (pasuri e peregjistruar) që ndodhet brenda rrethimit të tokës, ku kanë ndërtuar vilën vëllezërit e mi, A. Sh., D. Sh., L. Sh. dhe babai ynë, i ndjeri Xh. Sh..*

2.20 Subjekti, në mbështetje të deklarimeve, ka depozituar: (i) kopje të certifikatave; (ii) kartelat e pasurisë dhe hartën kadastrale për pasurinë e lartpërmendur, regjistruar në emër të babait të subjektit dhe vëllezërve të tij.

2.21 ASHK-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.6.2023, ka bërë me dije se nga verifikimi në sistemin digjital të vendimeve të legalizimit rezultojnë të pajisur me vendim legalizimi shtetasit Xh. T. Sh. dhe D. Xh. Sh. (vendim datë 30.7.2018, godinë banimi 3 kate, Njësia Administrative Nr. \*\*\* Tiranë).

2.22 Deklarimet e subjektit se ai ka shkëmbyer objektin me sip. 16 m<sup>2</sup> në truall me sip. 180 m<sup>2</sup> në \*\*\*, Tiranë, me vëllezërit dhe babanë e tij, pronë e cila i ishte dhuruar subjektit nga vëllezërit dhe babai i tij në vitin 1996 ngelen deklarative.

2.23 Komisioni çmon se referuar pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, subjekti, vëllezërit dhe babai i tij kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës së dhuruar, përdorur si burim krijimi për pasurinë e deklaruar në *Vetting*, objekt shqyrtimi.



2.24 Në lidhje me mundësinë financiare të vëllezërve, subjekti në pyetësin nr. 2 ka sqaruar se: *“Shuma e lekëve që i është dhënë bashkëshortes sime për të paguar për apartamentin ku banojmë dhe garazhin e makinës në rrugën “\*\*\*”, është dhënë cash nga babai im dhe vëllezërit e mi, ku babai im ka menaxhuar të ardhurat ndër vite të familjes (vëllezërit dhe motra). Lidhur me aftësinë financiare të vëllezërve të mi kam për të thënë se tre nga vëllezërit e mi dhe, konkretisht L. Sh., D. Sh. dhe A. Sh., për shumë vite kanë punuar në shtetin grek dhe më pas në SHBA. Në këtë shumë është përfshirë edhe një shumë lekësh të dërguara ndër vite nga motra ime A. D. (Sh.), vetë dhe bashkëshortit B. D. dhe të afërmve të këtij të fundit. Shuma e lekëve i është dhënë bashkëshortes sime cash nga babai im, i cili ka menaxhuar gjithë shumën e lekëve që i janë sjellë ndër vite nga vëllezërit nga emigracioni dhe ka qenë personi garant i kësaj marrëveshjeje të lidhur mes nesh. Nuk kam dokumente për mënyrën e dërgimit të lekëve”.*

2.25 Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion ligjor provues, as me plotësimin e deklaratës *Vetting* dhe as gjatë hetimit administrativ mundësinë financiare të vëllezërve dhe të babait, për krijimin me burime te ligjshme të shumës 181.000 euro.

2.26 Lidhur me shpjegimet dhe dokumentacionin e depozituar nga subjekti për vëllain e tij L. Sh., rezulton se datojnë pas janarit të vitit 2011, kësisoj, duke mos provuar mundësinë financiare lidhur me pagimin e shumës 181.000 euro deri në janar të vitit 2011.

2.27 Lidhur me shpjegimet dhe dokumentacionin e depozituar nga subjekti në lidhje me të ardhurat e motrës A. D., Komisioni vlerëson se subjekti, përveçse pas përgjigjeve në pyetësin nr. 2, duket se ka shtuar burimin e deklaruar mbi të ardhurat e vëllezërve dhe prindërve në shumën 181.000 euro (duke shtuar të ardhurat nga kontributi i motrës A. D.), për të cilat trupi gjykues vlerëson se duke u mbështetur edhe në vendimmarrjen e Kolegjit<sup>1</sup>, ky është një deklaram i kryer gjatë procesit të rivlerësimit dhe për shkak të tij nuk mund të merret në konsideratë dhe vjen në kundërshtim me deklarinimin në deklaratën *Vetting* se shuma është dhënë nga 4 vëllezërit e bashkëshortit dhe prindërit e tyre (babai).

2.28 Sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit për sa duket se: (i) nuk provohet marrëdhënia e pretenduar nga ana e subjektit të rivlerësimit lidhur me shkëmbimin e pasurive; (ii) nuk provohet burimi i ligjshëm i pagimit të pasurive të paluajtshme apartament dhe garazh në janar të vitit 2011, nga subjekti dhe personi i lidhur, për sa nuk provohet ligjshmëria e burimit të shumës 181.000 euro, përfituar nga vëllezërit dhe babai i subjektit; (iii) subjekti është përfshirë në një sërë transaksionesh me të afërmit e tij, të paprovuara nga ana ligjore e financiare, duke ngritur dyshime se ato janë hartuar nga palët vetëm me qëllim justifikimin e burimit të krijimit të shumës së përdorur si burim krijimi; (iv) subjekti ndodhet në kundërshtim me situatën e parashikuar nga neni D i Aneksit të Kushtetutës, lidhur me ligjshmërinë, saktësinë dhe plotësinë e deklarinimit të tij lidhur me këtë pasuri.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

2.29 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ka sqaruar: *“Në fillimet e demokracisë rreth vitit 1993, babai im, i ndjeri Xh. Sh., dhe vëllezërit e mi, A. Sh., D. Sh., H. Sh. dhe L. Sh., kanë blerë një sipërfaqe toke prej rreth 700 m<sup>2</sup>, por pa përpiluar ndonjë akt noterial, në vendin e quajtur ish-serrat e \*\*\*, Tiranë, në atë kohë vazhdimi i rrugës “\*\*\*”, aktualisht me adresat e reja: rruga “\*\*\*” nr. \*\*\*, Tiranë. Pagesën për këtë tokë në shumën 20.000 lekë (të reja), ia ka blerë babai im një qytetari nga Burreli, i cili hiqej si pronar i tokës, ndërkohë që nuk dispononte asnjë dokument për këtë tokë, veprim të cilin ky person e ka bërë edhe me të gjithë personat që kanë ndërtuar banesat në atë vend dhe aktualisht kanë bërë*

<sup>1</sup> Nr. 34/2019, datë 2.12.2019 dhe nr. 2/2020, datë 27.2.2020: *“[...] Kolegji arsyeton se referuar jurisprudencës së tij, deklarata noteriale të tilla merren me rezervë në këtë proces, pasi janë kryer gjatë procesit të rivlerësimit dhe për shkak të tij, çka të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit. Marrja me rezervë e deklaratave noteriale forcohet sidomos kur nuk mbështeten dhe nuk janë në harmoni me provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit [...]”.*

legalizimin e banesave ose janë në proces legalizimi. Në këtë parcelë toke, babai im Xh. Sh. dhe vëllezërit e mi, A. Sh., D. Sh., H. Sh. dhe L. Sh., kanë ndërtuar një vilë trekatëshe. Po ashtu, jashtë kësaj ndërtese, por brenda kësaj sipërfaqeje toke kanë ndërtuar një objekt 16 m<sup>2</sup>, me idenë që në të ardhmen të ndërtohej një shtëpi më vete. Pikërisht këtë objekt me sipërfaqe 16 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqen e tokës përreth, në total rreth 180 m<sup>2</sup>, babai dhe vëllezërit e mi ma dhuruan mua pa ndonjë akt të shkruar, pasi nuk dispononin asnjë dokument pronësie mbi këtë tokë. Si për vilën 3-katëshe të babait dhe vëllezërve të mi, ashtu edhe për objektin me sipërfaqe 16 m<sup>2</sup> dhe parcelën e tokës përreth është aplikuar për legalizim pranë ALUIZNI-t. Sipas formularit përkatës datë 18.8.2006, për të cilin është lëshuar vërtetimi me nr. \*\*\* prot. nga Njësia Bashkiake Nr. \*\*\*, Tiranë, për aplikimin dhe dorëzimin e dokumentacionit, për këtë aplikim ka dalë VKM-ja Nr. 677, datë 18.6.2009, për miratimin e kalimit të pronësisë për sip. 144.5 m<sup>2</sup> dhe sip. ndërtimi 13.9 m<sup>2</sup> në emrin tim, por nga interesimi në ALUIZNI Tiranë nuk është legalizuar, pasi sipërfaqja ndërtimore është e vogël dhe nuk plotësonte kriteret për legalizim. Në vitin 1998, unë sapo jam martuar, kam banuar në një banesë me qira të paguar nga familjarët e bashkëshortes sime, me kryefamiljar S. T., ngjitur me banesën e tyre në afërsi të Ministrisë së Jashtme Tiranë, kjo edhe për faktin se prindërit e bashkëshortes ishin të sëmurë dhe kishin nevojë për ndihmë të vazhdueshme. Ndërkohë, meqenëse unë nuk kisha interes më, për të vajtur tek ish-serrat e \*\*\*, ku kisha objektin që sipas VKM-së, është 144.5 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi 13.9 m<sup>2</sup> (ndonëse nuk kisha asnjë dokument për të); kur prindërit e bashkëshortes sime ishin të sëmurë dhe kërkonin ndihmën e kësaj të fundit që të ishte më pranë tyre; në kushtet kur babai dhe vëllezërit e mi donin të hapnim një biznes privat në fushën e prodhim dhe shitje mobiliesh, kjo edhe për faktin se dy prej tyre, A. Sh. dhe D. Sh., e njihnin zanatin e mobilierit dhe tapicierit, pasi kishin punuar për disa vite në Greqi dhe në Tiranë ose të ndërtonin një pallat. Për këtë arsye, kemi rënë dakord që prona që sipas VKM-së është 144.5 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi 13.9 m<sup>2</sup>, t'u jepej babait dhe vëllezërve të mi dhe në këmbim të kësaj pasurie më kanë dhënë lekët për të blerë shtëpinë dhe një garazh në rrugën "\*\*\*\*", në Tiranë, shtëpi ku unë banoj aktualisht. Kështu, në vitin 2010, vëllezërit e mi, A. Sh., D. Sh., H. Sh. dhe L. Sh., së bashku, nëpërmjet babait tim, më kanë dhënë mua dhe gruas sime, E. Sh., një shumë në total prej rreth 181.000 euro, të cilën gruaja ime ia ka paguar shtetasit A. N. për apartamentin dhe shoqërisë "\*\*\*\*" sh.p.k. për garazhin, në pallatin "\*\*\*\*", në rrugën "\*\*\*\*", Tiranë.

Lidhur me aftësinë financiare të vëllezërve të mi, kam për të thënë se tre nga vëllezërit e mi dhe konkretisht L. Sh., D. Sh. dhe A. Sh., për shumë vite kanë punuar në shtetin grek, ku dy prej tyre, L. dhe D., kanë punuar për rreth 14 vjet. Të ardhurat e L. i ka administruar babai im. L. ka qenë beqar, ka punuar fort në Greqi. Ka pasur synimet e veta për të ndërtuar një biznes në Tiranë, në fushën e mobilierisë, pasi këtë lloj pune e kishin bërë edhe në shtetin grek, por që më pas mendoi që të largohet për në Amerikë, ku banon edhe motra ime për rreth 20 vjetësh. L. ka emigruar nga Greqia për në Amerikë, ku në vitin 2010 është pajisur me numër pune. Pavarësisht faktit se u largua në Amerikë, likuiditetin siç e thashë më parë e ka menaxhuar dhe pasur babai im. Në dijeninë time, pjesën më të madhe të likuiditetit e ka dhënë L., pasi ka pasur likuiditet më tepër nga të tjerët. Fakti që likuiditetin e tij e ka menaxhuar babai im, ka të bëjë me atë që sipas traditës sonë prindërit jetojnë me më të voglin dhe L. është më i vogli nga ne vëllezërit, i cili çdo marrëdhënie financiare që kishte ia kishte besuar babait, i cili historikisht ka qenë arsimtar dhe drejtor shkollë. Prindërit e mi jetojnë në një apartament më vete në vilën që kishin ndërtuar, siç shpjegova edhe më lart. Sa i përket vlerës së këtij objekti dhe sipërfaqes së tokës rreth 180 m<sup>2</sup> (në total), deklaroj se kjo sipërfaqe toke është tokë truall dhe se në atë zonë janë bërë ndërtime pallatesh dhe po vijohet që edhe banesat e tjera, që e kanë hapësirën e nevojshme siç është prona e vëllezërve të mi, t'i kthejnë në pallate. Sa i përket vlerës që është konvertuar me sipërfaqen e tokës dhe objektin, kjo shumë është vërtet e konsiderueshme, por kjo është llogaritur ose marrë në konsideratë fakti se aty do të ndërtohej një pallat, meqenëse edhe sipërfaqja e tokës ishte e bollshme dhe mund të kishim përfitime të mëdha të konsiderueshme nga pallati. Në momentin që është bërë këmbimi, në këtë prizëm është trajtuar vlera e pasurisë sime. Nuk është bërë investim tjetër në atë vend. Kam paraqitur në ILDKPKI

dhe janë administruar në dosje edhe dokumente justifikuese për aftësinë paguese të njërit prej vëllezërve, L. Sh., i cili ka emigruar në USA, si kopje të llogarisë bankare, nr. pune; biznesi etj. Sipas deklaratës noteriale përkatëse, paraqitur në ILDKPKI, unë kam hequr dorë nga pasuria: objekt 16 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqja e tokës përreth, në total 180 m<sup>2</sup> tokë (pasuri e paregjistruar), që ndodhet brenda rrethimit të tokës, ku kanë ndërtuar vilën vëllezërit e mi, A. Sh., D. Sh., L. Sh. dhe babai ynë, i ndjeri Xh. Sh.. Deklaroj se fakti i konstatuar nga Komisioni (këtë gjë e kam deklaruar unë në vazhdimësi) se kjo pronë figuron edhe sot de facto në posedimin tim, nuk do të thotë se unë jam pronar i kësaj prone, përderisa ajo nuk është e regjistruar në emrin tim, por thjesht poseduar dhe as të dikujt tjetër, dhe se unë me vëllezërit e mi dhe babain kemi nënshkruar një deklaratë noteriale, përmendur sa më sipër, që unë kam hequr dorë nga kjo pronë dhe do t'u kalojë atyre. Nuk është përpiluar kontratë shitblerjeje prone, përderisa prona nuk është e regjistruar dhe sipas ligjit të noterisë nuk mund të shesësh një pronë kur nuk je pronar. Deklaroj se si vila, ashtu edhe objekti 16 m<sup>2</sup>, përmendur sa më sipër, nga fillimi deri në mbarim të tyre janë ndërtuar nga vetë vëllezërit e mi dhe babai im. Deklaroj se vila e babait dhe vëllezërve të mi dhe sipërfaqja e tokës rreth 700 m<sup>2</sup> është legalizuar dhe është regjistruar në ASHK Tiranë, në emër të vëllezërve të mi, A. Sh., H. Sh., D. Sh. dhe babait tim Xh. Sh. dhe konkretisht sipas certifikatës së regjistrimit të pasurisë, lëshuar në datën 6.10.2022, kodi unik \*\*\*, pasuria truall 277 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë 95.5 m<sup>2</sup>, është regjistruar në emër të D. Sh. (vëllai) dhe Xh. Sh. (babai). Kjo pasuri është 1/2 e vilës, krahu jugor. Sipas certifikatës së regjistrimit të pasurisë, lëshuar në datën 6.10.2022, kodi unik \*\*\*, pasuria truall 309 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë 95.5 m<sup>2</sup>, është regjistruar në emër të H. Sh. dhe A. Sh. (vëllezërit e mi). Kjo pasuri është 1/2 e vilës, krahu verior (shihni kartelën e pasurisë). Ndërkohë, objekti që sipas VKM-së është 144.5 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi 13.9 m<sup>2</sup>, që ndodhet brenda rrethimit të pronës së vëllezërve dhe babait tim, për të cilën unë kam hequr dorë nga posedimi i kësaj prone, nuk është legalizuar. Vëllezërit e mi janë interesuar për legalizimin e këtij objekti 144.5 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi 13.9 m<sup>2</sup>, me qëllim që edhe sipërfaqja tjetër tashmë e legalizuar të përdoret prej tyre për të ndërtuar një pallat me garazhe, dyqane dhe apartamente banimi dhe patjetër kati i parë do të shfrytëzohet për biznes. Në bazë të deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 22.6.2016, është rënë dakord që kjo pasuri sapo të legalizohet/regjistrohet, t'u kalojë në pronësi vëllezërve të mi A. Sh., D. Sh., H. Sh. e L. Sh. dhe babait tim Xh. Sh., të cilët kanë kontribuar/dhënë paratë për blerjen e shtëpisë sime, që kam aktualisht në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë”.

2.30 Subjekti paraqiti në cilësinë e provës kopje të certifikatave dhe kartelat e pasurisë për pasurinë e lartpërmendur, regjistruar në emër të babait të subjektit dhe vëllezërve të tij.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

2.31 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat në përgjigje të barrës së provës – arsyeton se:

2.32 Referuar pikës 1, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës, në përputhje me përcaktimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave përkatëse të ligjit nr. 84/2016, në kuptim të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, këto pasuri, sipas kuptimit të dhënë në pikën 11, të nenit 3, të ligjit 84/2016, objekt deklarimi në deklaratën e pasurisë *Vetting*, i nënshtrohen kontrollit të plotë mbi vërtetësinë, saktësinë e deklarimit dhe ligjshmërinë e burimeve, pa dallim e kufizim.

2.32.1 Neni 4 i ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënspunësve publikë” detyron subjektet të deklarojnë pasuritë e paluajtshme dhe burimin e tyre. Subjekti ka treguar kujdes të deklarojë një burim të caktuar, lidhur me këto pasuri, pavarësisht nga mungesa e dokumentacionit të plotë shoqërues-provues që duhet të përmbushi kriteret e kërkuara nga ligji lidhur me

ligjshmërinë në formë dhe përmbajtje. Komisioni vlerëson se vetëm fakti që një burim është deklaruar në deklaratat periodike dhe në dokumente të cilat në themel bazohen në thënie të paleve, nuk nënkupton apo provon ekzistencën e burimit në sasinë apo rrethanat e deklaruara.

2.32.2 Trupi gjykues vlerëson se mbështetur në përcaktimet e pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 dhe pikës 19, të Udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së, në analizë të shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit lidhur me pasurinë truall me sip. 180 m<sup>2</sup> dhe ndërtim me sip. 16 m<sup>2</sup> të ndodhura në \*\*\* dhe marrëdhënien e pretenduar me vëllezërit dhe babain e tij, nuk ka asnjë akt ligjor me fuqi të plotë provuese mbi të cilat subjekti të bazojë pretendimet e tij mbi pronësinë e truallit dhe dhurimit të këtij trualli dhe ndërtimit mbi të nga babai dhe vëllezërit e tij. Deklarimi i subjektit i pambështetur në dokumentacion mbetet në nivel deklarativ dhe i paprovuar.

2.33 Trupi gjykues analizoi deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 22.6.2016, sipas së cilës vëllezërit dhe babai i subjektit deklarojnë se *“rreth vitit 1993, Xh., A., D., H. dhe L. Sh. kanë blerë pa akt noterial një sipërfaqe toke rreth 700 m<sup>2</sup> në vendin e quajtur Serrat e \*\*\*, vazhdimi i rrugës “\*\*\*”, sot “\*\*\*”, nr. \*\*\*, Tiranë, dhe kanë ndërtuar vilë trekatëshe me 6 hyrje. Gjithashtu, jashtë kësaj ndërtese, por brenda të njëjtës sipërfaqe toke kanë ndërtuar një objekt me sip. 16 m<sup>2</sup>, të cilin, bashkë me tokën me sip. 180 m<sup>2</sup> përreth, ia kanë dhuruar pa akt të shkruar Bardhyl Shehut. Asnjë nga ndërtimet e aplikuara për legalizim nuk është legalizuar. Bardhyl Shehu, në vitin 1998, kur është martuar, ka jetuar me qira pranë banesës së prindërve të bashkëshortes, të cilët kishin nevojë për përkujdesje dhe nuk kishte interes të kthehej tek objekti dhe trualli në \*\*\*. A., D., H. dhe L. Sh., duke dashur të hapnin aktivitet biznesi për prodhim-shitje mobilierie, i kanë kërkuar Bardhyllit t’i japë pronën e tij, objektin me sip. 16 m<sup>2</sup> në parcelën e tokës prej 180 m<sup>2</sup>, për të ndërtuar një objekt më të madh për biznesin, në këmbim të mjeteve monetare për të blerë shtëpi dhe garazh në rrugën “\*\*\*”. Në vitin 2011, A., D., H. dhe L. Sh. i kanë dhënë Bardhyl dhe E. Sh. shumën prej 181.000 euro për blerjen e banesës dhe garazhit në rrugën “\*\*\*”, pallati “\*\*\*”.*

2.34 Trupi gjykues vlerëson se kjo deklaratë noteriale, pavarësisht se si është cilësuar nga palët, është një marrëveshje *sui generis*, e cila ka për shkak kryesor shkëmbimin e një sendi të paluajtshëm me një sasi vlere monetare, veprim juridik i cili mund të materializohet vetëm kur pronësia mbi sendin e paluajtshëm pranohet dhe provohet se ekziston.

2.35. Trupi gjykues vlerëson se për sa titulli i fitimit të pronësisë së pretenduar të subjektit nuk provohej, deklarimi noterial mbi fakte apo marrëveshje pretenduar mes subjektit dhe vëllezërve dhe babait të tij nuk provoheshin për sa i përket ligjshmërisë e veprimit juridik të deklaruar.

2.36 Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se kjo deklaratë noteriale e vetme nuk përbën dokumentacion ligjor për të provuar pronësinë mbi sendin e paluajtshëm apo edhe për të legjitimuar marrëveshjen e arritur mes palëve mbi dakordësinë për shkëmbim të pronësisë mbi sendin e paluajtshëm me vlerën monetare të dhënë, pretenduar mes palëve.

2.37 Subjekti nuk paraqiti asnjë dokumentacion ligjor provues për të provuar ekzistencën e një titulli pronësie që i referohet një veprimi juridik për kalimin e pronësisë, lidhur me pasurinë objekt i deklaratës noteriale, element që jo vetëm do të legjitimonte ligjshmërinë e veprimit për përfitimin e të ardhurave prej 180.000 euro, në kuptim të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, por edhe do të përcillte doza të rëndësishme rreth besueshmërisë së ekzistencës së kësaj marrëdhënieje në kohën e pretenduar.

2.38 Shuma e pretenduar, si e marrë nga subjekti prej vëllezërve të tij, prej 181.000 euro referuar vlerës së madhe të saj, nuk u shoqërua me asnjë gjurmë mbi ekzistencën e saj në llogari bankare, si dhe fakti se sipas marrëveshjes palët dakordësuan se trualli brenda rrethimit të banesës së vëllezërve dhe një dhomë e ndërtuar mbi të, ndodhur në zonën e \*\*\*, u vlerësuan sa vlera e një apartamenti dhe garazhi në një nga zonat qendrore të qytetit të Tiranës, krijuan bindjen e trupit gjykues se ky transaksion i pretenduar nga ana e subjektit ishte jo vetëm i pabesueshëm, por edhe sfidonte logjikën ekonomike.

2.39 Për sa u përket shpjegimeve dhe dokumentacionit provues të depozituar nga subjekti për të provuar mundësinë financiare të vëllezërve dhe babait të tij për dhënien e vlerës 181.000 euro subjektit trupi gjykues vlerësoi pas analizimit të tyre se subjekti i rivlerësimit me provat e dokumentacionin e depozituar nuk provoi mundësinë financiare të vëllezërve dhe babait të tij për krijimin me të ardhura të ligjshme prej tyre të shumës 181.000 euro.

2.40 Në pikëpamjen e ligjshmërisë së vetë shumës 181.000 euro, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti nuk arriti të provojë ligjshmërinë e burimeve financiare që kanë shërbyer për krijimin e shumës 181.000 euro. Shpjegimet dhe dokumentacioni i depozituar nga subjekti për vëllain e tij L. Sh., rezulton se datojnë pas janarit të vitit 2011, kështu, duke mos provuar mundësinë financiare lidhur me pagimin e shumës 181.000 euro deri në janar të vitit 2011.

2.41 Lidhur me pretendimet e subjektit dhe dokumentacionin e depozituar nga ai sa i përket të ardhurave të motrës A. D., shërbyer për krijimin e shumës 181.000 euro trupi gjykues vlerësoi se subjekti, vetëm pas përgjigjeve në pyetësorin nr. 2, ka shtuar burimin e deklaruar për shumën 181.000 euro duke shtuar të ardhura nga kontributi i motrës së tij znj A. D..

2.42 Trupi gjykues vlerëson mbështetur edhe në vendimmarrjen e Kolegjit<sup>2</sup>, se ky deklaram i kryer gjatë procesit të rivlerësimit dhe për shkak të tij, nuk mund të merret në konsideratë pasi vjen në kundërshtim me deklaramin në *Vetting* ku shuma është deklaruar si e dhënë nga 4 vëllezërit e dhe babai, pa u përmendur si burim krijimi motra e tij. Pretendimet lidhur me të ardhurat e motrës, deklaruar nga subjekti vetëm në fundin e hetimit administrativ, nuk mund të merren në konsideratë dhe u vlerësuan se u bënë nga subjekti vetëm për efekt rregullimi të pamundësisë financiare të vëllezërve dhe babait të tij, sipas rezultateve të hetimit administrativ.

2.43 Referuar fakteve dhe provave lidhur me pasuritë objekt hetimi, trupi gjykues arriti në konkluzionin se transaksionet e pretenduara dhe dokumentacioni ligjor i hartuar nga subjekti me vëllezërit e babain e tij, të paprovuara nga ana ligjore e financiare, janë hartuar vetëm me qëllim justifikimin e burimit të krijimit të shumës së përdorur nga subjekti i rivlerësimit si burim krijimi për pasuritë apartament dhe garazh, në rrugën “\*\*\*\*” Tiranë në vitin 2011.

2.44 Në përmbyllje të vlerësimit e kontrollit që iu bë pasurive apartament dhe garazh, të ndodhura në rrugën “\*\*\*\*” në Tiranë, në pronësi të subjektit të rivlerësimit, duke mbajtur në konsideratë mungesën e provueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e shumës së pretenduar, 181.000 euro dhe faktin se subjekti dështoi të provojë ligjshmërinë e veprimit të përfitimit të kësaj shume, çojnë trupin gjykues në konkluzionin se subjekti dështoi të provojë burimet financiare të ligjshme të përdorura prej tij për krijimin e pasurive apartament dhe garazh, në rrugën “\*\*\*\*”, në Tiranë, referuar standardit dhe kërkesave të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, dhe ndodhet në kushtet e parashikimeve të gërmave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

### **3. Automjet tip “\*\*\*\*”, blerë në vitin 2008, me vlerë 2.000 euro**

3.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti deklaroi: “*Makinë “\*\*\*\*”, me targë \*\*\*, prodhim i vitit 2000. Blerë në shumën 2.000 euro, sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 31.1.2008. Zhdoganuar në datën 28.1.2008. Paratë janë dhuruar nga kunati im/vëllai i gruas, A. T., i cili është biznesmen dhe administrator i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. (\*\*\*) me nr. identifikimi NIPT \*\*\*\**”.

3.2 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) kontratë shitblerjeje automjeti nr. \*\*\*, datë 31.1.2008, sipas së cilës z. Bardhyl Shehu blen automjetin tip “\*\*\*\*” me targë \*\*\*, kundrejt çmimit 2.000 euro; (ii) dokument zhdoganimi datë 28.1.2008, në shumën 142.874 lekë; (iii)

---

<sup>2</sup> Nr. 34/2019, datë 2.12.2019; nr. 2/2020, datë 27.2.2020: “[...] Kolegji arsyeton se referuar jurisprudencës së tij, deklarata notoriale të tilla merren me rezervë në këtë proces, pasi janë kryer gjatë procesit të rivlerësimit dhe për shkak të tij, çka të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit. Marrja me rezervë e deklaratave notoriale forcohet sidomos kur nuk mbështeten dhe nuk janë në harmoni me provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit [...]”.

DPSHTRR-ja, me shkresat e protokolluara me tonat me nr. \*\*\* prot., datë 17.7.2017 dhe datë 9.8.2017, konfirmon automjetin me targë \*\*\*, në emër të subjektit Bardhyl Shehu.

3.3 Në DPV-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar: *“Makinë \*\*\*\*”, me targë \*\*\*, blerë, me lekë të dhuruara nga kunati A. T. në shkurt 2008”*.

3.4 Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 23.6.2016, subjekti ka deklaruar: *“Në datën 31.12.2014, në familje kemi vetëm automjetin si më sipër me targë \*\*\*. Në bazë të kontratës së blerjes, vlera e automjetit është në shumën 2.000 euro dhe këtë likuiditet e kam marrë nga kunati im, deklaratë të cilën e paraqita për t’u administruar në dosje”*. Në pyetësorin standard, subjekti ka deklaruar: *“Në vitin 2008 më është dhuruar një makinë \*\*\*\* me targë \*\*\*, prodhim i vitit 2000, blerë në shumën 2.000 euro. Paratë janë dhuruar nga kunati im, vëllai i gruas A. T., i cili është biznesmen dhe administrator i \*\*\*\* sh.p.k.”*.

3.5 AMF-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.2.2021, ka konfirmuar mbulimin me sigurim të automjetit në fjalë nga ana e subjektit, nga data 6.7.2020 deri më 5.7.2021.

3.6 DPSHTR-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.1.2021, ka vendosur në dispozicion të Komisionit dosjen e automjetit, nga ku rezulton: (i) certifikata e pronësisë së automjetit në emër të shtetasit Bardhyl Xh. Shehu për automjetin tip \*\*\*\*, vit prodhimi 2000; (ii) kontrata e shitblerjes së automjetit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 31.1.2008, me shitës P. D. dhe blerës subjekti Bardhyl Xh. Shehu, për automjetin tip \*\*\*\*, ku është pasqyruar çmimi 2.000 euro; (iii) faturë shitblerjeje në emër të shtetasit P. D., që konfirmon blerjen e automjetit në datën 15.1.2008; (iv) sipas deklaratës doganore nr. \*\*\*, datë 27.1.2008, vlera e këtij automjeti është 4.300 euro dhe shpenzimet doganore kanë qenë në vlerën 314.835 lekë, pra në total shitësi i automjetit ka paguar 4 ditë përpara se t’ia shiste subjektit të rivlerësimit shumën prej 838.489 lekësh.

3.7 Në lidhje me mospërputhjen ndërmjet çmimit të blerjes nga ana e shitësit me çmimin e pasqyruar në kontratën e shitblerjes së automjetit, subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar: *“Siç e kam thënë edhe gjatë deklaramit të mëparshëm, leket për makinën i ka paguar kunati im A. T. Nga biseda që kam bërë me kunatin për këtë problematikë, që është konstatuar nga ana juaj, më është shprehur se në kontratë është vënë një çmim i tillë, për shkak se me shitësin P. D. kanë pasur marrëdhënie pune/biznesi dhe kaq ishte detyrimi që ka pasur ndaj tij, duke llogaritur edhe vlerën e makinës. Nuk kam pasur asnjë marrëdhënie pune dhe as marrëdhënie tjetër të çfarëdoshme me shitësin e kësaj makine P. D.. Burimi i të ardhurave të kumatit tim A. T. ka qenë biznesi i tij”*.

3.8 Në mbështetje të shpjegimeve, subjekti ka depozituar dokumentacionin: (i) vendim nr. \*\*\*, për regjistrimin e personit juridik \*\*\*\* sh.p.k., me ortak të vetëm A. T.; (ii) certifikatë regjistrimi e personit të tatuueshëm \*\*\*\* sh.p.k.; (iii) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 27.6.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (ish-Prokuroria e Rrethit Krujë), që konfirmon se subjekti nuk ka ndjekur materiale kallëzuese apo procedime penale me shtetasin P. D.; (iv) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.6.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë që konfirmon se subjekti nuk ka ndjekur materiale kallëzuese apo procedime penale me shtetasin P. D..

3.9 Sa më sipër, duket se kontrata e shitblerjes e lidhur nga subjekti me shtetasin P. D. është bërë për të shmangur deklarin e vlerës së plotë të automjetit. Për sa automjeti është zhdoganuar 4 ditë përpara se t’i shitej subjektit, Komisioni vlerësoi se subjekti ka paguar vlerën e plotë të këtij automjeti, e cila nga hetimi rezultoi se ishte 838.489 lekë. Pretendimet e subjektit mbi marrëveshje të mëparshme apo detyrimeve mes palëve nuk provohen nga dokumentacioni ligjor i hartuar mes palëve, kontrata e shitblerjes. Komisioni ka vlerësuar se automjeti është blerë nga subjekti në vlerën 838.489 lekë dhe se deklarimi i vlerës së automjetit në deklaratën Vetting dhe në dokumentacionin e hartuar është bërë vetëm për të justifikuar burimin e krijimit të kësaj pasurie të luajtshme prej tij.

3.10 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, për sa duket se: (i) ka deklarim të pasaktë në deklaratën *Vetting* të vlerës së automjetit, pasi vlera e tij, referuar fakteve nga hetimi, nuk përputhet me vlerën e parashikuar në kontratën e hartuar mes palëve dhe se parashikimi i çmimit në kontratë është bërë vetëm për justifikimin e burimit të ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie; (ii) subjekti është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë e tij automjet.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

3.11 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ka sqaruar: *“Siç e kam thënë edhe gjatë deklaramit të mëparshëm, lekët për makinën i ka paguar kunati im A. T., i cili për këtë fakt ka lëshuar edhe një deklaratë noteriale, të cilën e kam paraqitur në deklaratën *Vetting*. Nga biseda që kam bërë me kunatin për këtë problematikë, që është konstatuar nga ana juaj, më është shprehur se në kontratë është vënë një çmim i tillë, për shkak se me shitësin P. D. kanë pasur marrëdhënie pune/biznesi dhe kaq ishte detyrimi që ka pasur ndaj tij, duke llogaritur edhe vlerën e makinës. Nuk kam pasur asnjë marrëdhënie pune dhe as marrëdhënie tjetër të çfarëdoshme me shitësin e kësaj makine, P. D..*

*Burimi i të ardhurave të kumatit tim A. T. ka qenë biznesi i tij. Për të provuar këtë fakt kam vënë në dispozicion bashkëlidhur shpjegimeve të pyetësorit të dytë edhe një deklaratë të lëshuar nga vetë pronari i makinës, shtetasi P. D.. Dua të theksoj se gjatë gjithë kohës që nga viti 1998, kur unë kam lidhur martesën me bashkëshorten, dhe deri në vitin 2013, kur kemi hyrë në shtëpi, në rrugën “\*\*\*”, kemi jetuar/banuar pranë prindërve të bashkëshortes, nga viti 1998 deri në vitin 2004, në një banesë me qira të paguar prej tyre, ngjitur me apartamentin e tyre dhe nga viti 2005 deri në vitin 2013, kemi jetuar në banesën e tyre. Në këtë kontekst, edhe makina është paguar nga kunati im, me qëllim më tepër për t’ju shërbyer prindërve të tij të sëmurë, të cilët kishin nevojë që të shkonin herë pas here në spital (vjehrira ime atë vit që është blerë makina është operuar dhe duhej të ndiqej nga mjekët në vazhdimësi, duke e dërguar pothuajse çdo dy-tre ditë në spital për të bërë fizioterapi) etj.”.*

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

3.12 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaramet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaramet periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat në përgjigje të barrës së provës – arsyeton se:

3.13 Trupi gjykues vëren se shpjegimet e subjektit nuk referohen nga kontrata e shitblerjes se hartuar mes palëve qoftë përsa i përket palëve apo dhe vlerës së parashikuar.

3.14 Lidhur me vlerën provuese të deklaratës noteriale të shtetasit P. D., bazuar edhe në qëndrimet që ka mbajtur Kolegji në çështje të ndryshme, trupi gjykues vlerësoi se fuqia provuese e saj në këtë proces nuk është bindëse, pasi është kryer gjatë procesit të rivlerësimit, çka krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarameteve të subjektit të rivlerësimit.

3.15 Trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e dhëna nga subjekti nuk janë bindëse, nuk mbështeten nga provat e rezultuara nga hetimi administrativ dhe nuk provojnë të kundërtën e barrës së provës lidhur me këtë pasuri të luajtshme.

3.15.2 Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë automjet, referuar vlerës reale të paguar prej tij dhe ndodhet në kushtet e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë këtë pasuri dhe të justifikojë burimet e ligjshme duke u ndodhur në situatën faktike të përcaktuara nga gerrat “a”, “b” dhe “ç”, të pikës 5, të nenit 33 dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

#### **4. Truall me sip. 1.058 m<sup>2</sup>, në blv. “\*\*\*\*”, me çmim 45.094.790 lekë**

4.1 Referuar dosjes së ILDKPKI-së, është administruar shkresa nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2018, e ZRPP-së, që ka bashkëlidhur praktikën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, nga ku rezulton: (i) kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 7.10.2009, sipas së cilës personi i lidhur me subjektin, znj. E. Sh., blen nga 8 bashkëpronarë truall me sip. 1.058 m<sup>2</sup>, në blv. “\*\*\*\*”, kundrejt çmimit 45.094.790 lekë. Me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.8.2010, personi i lidhur me subjektin, znj. E. Sh., dhe subjekti i shesin shtetasit L. M. truallin me sip. 1.058 m<sup>2</sup>, në blv. “\*\*\*\*”, kundrejt çmimit 45.094.790 lekë.

4.2 Në kontratën e shitjes konstatohet se prona është e bllokuar në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në bazë të kontratës nr. \*\*\*, datë 27.10.2009 dhe pala blerëse pranon blerjen me bllokimin e pronës dhe merr përsipër të respektojë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontrata e sipërmarrjes me shoqërinë.

4.3 Nga verifikimi i deklarimeve në ILDKPKI, konstatohet se subjekti Bardhyl Shehu është larguar nga funksioni në datën 2.9.2009, duke dorëzuar deklaratën “Pas largimit nga funksioni” në datën 25.5.2010 dhe nuk ka deklaruar ndryshime në pasuri apo detyrime. Në DPV, pas largimit nga funksioni, dorëzuar në vitin 2010, personi i lidhur me subjektin apo subjekti nuk e kanë deklaruar këtë pasuri të blerë nga personi i lidhur, znj. E. Sh..

4.4 Sipas praktikës së ZRPP-së, rezulton se: (i) në seksionin D të kartelës së pasurisë është vënë shënimi “Mbi këtë pasuri ndodhet objekti – ndërtesa me nr. pasurie \*\*\* (\*\*\*, ish-\*\*\*\*)”; (ii) në seksionin E të kartelës së pasurisë është vënë shënimi “Kjo pasuri, në bazë të kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 27.10.2009, është bllokuar në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. për ndërtim shumëkatësh”. Prona shitet me kushtin që të qëndrojë e bllokuar në favor të shoqërisë së ndërtimit, duke marrë përsipër të respektojë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontrata e sipërmarrjes; kartelë pasurie për truall me sip. 1.058 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, regjistruar në datën 21.9.2017, në pronësi të shtetasit A. T. (sipas kontratës së shitjes me kusht nr. \*\*\*, datë 15.9.2017 dhe deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 9.9.2017).

4.5 Komisioni administroi edhe dokumentacionin e përcjellë nga noterja Sh. Sh. nga ku rezulton se: (i) me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 7.10.2009, personi i lidhur me subjektin, znj. E. Sh., ka blerë nga 8 bashkëpronarë një truall me sip. 1.058 m<sup>2</sup>, në blv. “\*\*\*\*”, kundrejt çmimit 45.094.790 lekë; (ii) me kontratën e sipërmarrjes për dhënie trualli në ndërtim, me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 27.10.2009, me objekt “Realizimi, investimi dhe ndërtimi i një objekti godinë polifunksionale”, znj. E. Sh. (në cilësinë e pronarit të truallit) ka vendosur në dispozicion të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. pasurinë truall, me qëllim që kjo e fundit, në bazë të lejes së ndërtimit që do të miratohet nga KRT-ja, të bëjë ndërtimin e godinave shumëkatëshe, duke përfituar pronari i truallit 38% të sipërfaqes së ndërtimit dhe ambienteve të përbashkëta; (iii) më pas, me kontratë shitblerjeje datë 21.8.2010, znj. E. Sh. i ka shitur shtetasit L. M., në cilësinë e administratorit të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., pasurinë e sipërcituar truall me sip. 1.058 m<sup>2</sup>, në blv. “\*\*\*\*”, kundrejt çmimit 45.094.790 lekë, me detyrimin që pala blerëse të respektojë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontrata e sipërmarrjes me shoqërinë. Subjekti ka firmosur te kjo kontratë shitjeje.

4.6 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit, i pyetur në lidhje me burimin e ligjshëm të përdorur nga personi i lidhur dhe përfitimin që do të kishte personi i lidhur nga kontrata e sipërmarrjes, ka sqaruar: *“Gjatë periudhës 2.9.2009 deri më 9.1.2013 nuk kam ushtruar detyrën time si prokuror, për shkak të shkarkimit tim me propozim të ish-kryeprokurores, një vendim ky i paligjshëm, i shfuqizuar me vendim përfundimtar të Gjykatës së Lartë, madje edhe Gjykatës Kushtetuese. Për shkak të sa më sipër, deri në datën kur jam rikthyer në detyrën e prokurorit, 9.1.2013, detyrë që ushtroj edhe sot, unë dhe familjarët e mi nuk kemi qenë subjekt të deklarimeve pranë organit të ILDKPKI-së. Nuk kam pasur asnjë dijeni lidhur me këtë kontratë që ju shpreheni se bashkëshortja ime ka firmosur për blerjen e një trualli në Tiranë, në vlerën 45.000.000 lekë, deri në momentin që këtë fakt e kam mësuar nga pyetësi i dërguar prej jush dhe kjo ka qenë edhe arsyeja përse nuk figuron e deklaruar në*



*DIP-në para fillimit të detyrës shkurt 2013 dhe as në vazhdimësi në DIP-të periodike vjetore. Megjenëse nuk e kam këtë kontratë, në kushtet kur edhe vëllai i bashkëshortes është jashtë shtetit, nuk kam pasur mundësi që të komunikoj me të dhe të shprehem në këtë pyetësor për rrethanat e kësaj kontrate. Do t'ju kthej një përgjigje sapo vëllai i bashkëshortes do të kthehet në Shqipëri”.*

4.7 Komisioni konstatoi se lidhur me shitjen e kësaj pasurie dhe të ardhurat e përfituara nuk provohet destinacioni dhe këto të ardhura nuk deklarohen në asnjë nga deklaratimet periodike të subjektit apo të personit të lidhur dhe as në deklaratën *Vetting*.

4.8 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se: (i) të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie në vlerën 45.000.000 lekë nuk janë deklaruar në deklaratën *Vetting*; (ii) nuk provohet burimi i ligjshëm i krijimit të pasurisë në vlerën 45.000.000 lekë nga subjekti dhe personi i lidhur me subjektin, znj. E. Sh., për blerjen e truallit me sip. 1.058 m<sup>2</sup>, në blv. “\*\*\*\*”, Tiranë; (iii) duket se ngrihen dyshime lidhur me veprimet noteriale të kryera mes palëve lidhur me shitjen e kësaj pasurie, si dhe mosdeklarimin e të ardhurave të përfituara; (iv) subjekti dhe personi i lidhur ndodhen në situatën e parashikuar nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, lidhur me këtë pasuri, të drejtat dhe të ardhurat e përfituara prej saj.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

4.9 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ka sqaruar: *“Gjatë periudhës shtator 2.9.2009 deri në datën 9.1.2013, nuk kam ushtruar detyrën time si prokuror, për shkak të shkarkimit tim me propozim të ish-kryeprokurores, ndryshe nga ç’kishte sugjeruar grupi i kontrollit të Prokurorisë së Përgjithshme, një vendim ky i paligjshëm, i shfuqizuar me vendim përfundimtar të Gjykatës së Lartë, madje edhe Gjykatës Kushtetuese. Për shkak të sa më sipër, deri në datën kur jam rikthyer në detyrën e prokurorit, 9.1.2013, detyrë që ushtroj edhe sot, unë dhe familjarët e mi nuk kemi qenë subjekt të deklarimeve pranë organit të ILDKPKI-së. Nuk kam pasur dijeni lidhur me kontratën e shitblerjes kur bashkëshortja ime ka nënshkruar për blerjen e truallit, përshkruar sa sipër. Dua të deklaroj se nga komunikimi që kam pasur aktualisht me bashkëshorten time dhe vëllain e saj, bashkëshortja ime e ka nënshkruar këtë kontratë në mirëbesim, si “përfaqësuese” e vëllait të saj, për shkak se ky i fundit ato ditë nuk kishte mundësi të vinte në Tiranë dhe se palët shitëse, gjithsej 8 persona, nuk mund të ishin të disponueshëm ditë tjetër për t’u paraqitur tek noteri. Për këtë fakt, kunati im ka nënshkruar një deklaratë, që mban datën 15.7.2023, të cilën po jua vë në dispozicion, ku thuhet, citoj: “Në vitin 2008, pasi kisha hyrë në bisedime me pronarët e një trualli tek ish-ekspozita “Shqipëria Sot” (L. H., E. R., M. R., J. R., F. R., V. R. dhe Dh. D., kishim renë dakord që unë t’jua blija këtë pronë. Në datën 7.10.2009 kishim renë dakord që të paraqiteshim tek noteri për të nënshkruar kontratën e shitblerjes.*

*Megjenëse atë ditë nuk kisha asnjë mundësi të vija në Tiranë, në kushtet kur pala shitëse, që ishin gjithsej 8 persona, nuk mund të ishin të disponueshëm të gjithë ditë tjetër për t’u paraqitur tek noteri, i kam thënë motrës time E. T. që të shkonte të firmoste kontratën në mirëbesim. Më pas, në vitin 2010, është bërë shitja e këtij trualli shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe se, edhe në këtë rast, motra ime ka nënshkruar sërish në mirëbesim, për shkak të veprimit të mësipërm. Deklaroj se motra ime nuk ka përfituar asgjë nga kjo pronë dhe se nënshkrimi në kontratën e blerjes dhe shitjes së kësaj prone nga motra ime është bërë për arsytet e lartpërmendura, në mirëbesim. Marrëdhëniet e mia janë tërësisht familjare mes motrës dhe vëllait, në mirëbesim. Fakti se në këtë transaksion bashkëshortja ime ka nënshkruar kontratën për shkaqet e sipërpërmendura, del qartë edhe po t’i referohemi edhe një kontrate sipërmarrjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 13.3.2008, lidhur mes palës pronare të truallit (L. H., E. R., M. R., J. R., F. R., V. R. dhe Dh. D.) dhe palës sipërmarrëse, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., përfaqësuar nga A. T. (vëllai i bashkëshortes) dhe “\*\*\*\*” sh.p.k., me administrator E. M., përfaqësuar nga L. M.. Kjo kontratë kërkoj që të shqyrtohet nga Komisioni dhe të administrohet si provë.*

*Deklaroj se bashkëshortja ime nuk ka dhënë asnjë lek nga shuma që figuron në kontratën e shitblerjes kur ka blerë truallin dhe nuk ka asnjë dijeni se në ç'mënyrë janë dhënë lekët shitësve të truallit, ndërkohë që vëllai i bashkëshortes është biznesmen. Lidhur me kontratën e shitjes së këtij trualli, pasi kam marrë një kopje të kontratës nga noteri, kam konstatuar se në këtë kontratë kam firmosur edhe unë si bashkëshort/familjar i shitësit (bashkëshortes time). Bashkëshortja ime nuk ka përfituar asnjë lek nga shuma që figuron në kontratën e shitjes dhe nuk ka asnjë dijeni se në ç'mënyrë janë marrë lekët blerësit të pronës. Referuar faktit se këto veprime janë kryer në periudhën kur unë nuk kam qenë subjekt deklarimi; kur këto veprime janë kryer 3 vjet para se unë kisha detyrimin të deklaroja (DIP); kur nuk kemi përfituar asnjë gjë nga këto veprime në mirëbesim të bashkëshortes; kur këto veprime (blerja dhe më pas shitja) janë kryer brenda një harku kohor të shkurtër (disa muaj) në periudhën kur nuk kisha detyrim të deklaroja); në kushtet kur nuk kam qenë i qartë nëse duheshin deklaruar apo jo këto veprime, pasi prona e blerë është shitur brenda pak muajsh dhe pozita jonë karshi kësaj prone, referuar faktit se nënshkrimi në kontratë ishte në mirëbesim, për shkak që përmenda më sipër etj., për këto arsye nuk e kam fiksuar këtë moment të nënshkrimit të kontratës së shitjes si bashkëshort/familjar i shitësit dhe nuk e kam mbajtur mend, që ta deklaroja në DIP-në para fillimit të detyrës, shkurt 2013 dhe as në vazhdimësi në DIP-të periodike vjetore, as në deklaratën Vetting 2016.*

*Si mund të mos e deklaroja një gjë të tillë kur bëhet fjalë për një pronë të paluajtshme, me një vlerë të konsiderueshme, e cila regjistrohet, shënohet a dokumentohet në disa institucione, si ZRRPP, zyra noterie etj., përveçse për arsyet që përmenda më lart?! Sa i përket burimit të të ardhurave lidhur me këto transaksione, deklaroj se neve nuk jemi përfshirë fare në dhënien apo marrjen e lekëve, respektivisht nga blerja dhe shitja e pronës, pasi me këtë është/duhet të jetë marrë vëllai i bashkëshortes. Dua të deklaroj se nga verifikimi i kryer në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (Dhoma Civile), referuar vërtetimit të lëshuar në datën 29.6.2023 nga kjo gjykatë, vëllai i bashkëshortes time është në proces gjyqësor për pasurinë e lartpërmendur, me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k. Ky vërtetim kërkoj që të shqyrtohet nga Komisioni dhe të administrohet si provë. Nuk kam dijeni për riblerjen e kësaj prone nga kunati im A. T. më 21.9.2017 (sipas kontratës së shitjes me kusht nr. \*\*\*, datë 15.9.2017). Deklaroj nën përgjegjësinë time se as unë dhe as bashkëshortja ime apo djali im nuk kemi pasur asnjë lloj përfitimi nga marrëdhënia e pronësisë me pasurinë e paluajtshme, përshkruar sa sipër, por veprimet e bashkëshortes janë kryer në mirëbesim, për arsyet e lartpërmendura dhe për shkak të marrëdhënies vëlla-motër. Së fundmi, dua të deklaroj se me përfaqësuesin e shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. a punonjës të tjerë të kësaj shoqërie dhe me pronarët e truallit (L. H., E. R., M. R., J. R., F. R., V. R. dhe Dh. D.), që figurojnë në kontratë si “shitës”, nuk kam pasur asnjë marrëdhënie pune dhe as marrëdhënie tjetër të çfarëdoshme, nuk jam takuar asnjëherë dhe nuk kam biseduar a komunikuar asnjëherë dhe në asnjë mënyrë me ta. Nuk kam hetuar apo trajtuar asnjë çështje me personat e lartpërmendur”.*

4.10 Subjekti paraqiti në cilësinë e provës dokumentacionin: (i) deklaratë noteriale datë 15.7.2023, me deklarues shtetasin A. T., i cili, ndër të tjera, deklaroi: “Në vitin 2008, pasi kisha hyrë në bisedime me pronarët e një trualli tek ish-ekspozita, kishim rënë dakord që unë ta blija këtë pronë. Në datën 7.10.2009 kishim rënë dakord që të paraqiteshim tek noteri për të nënshkruar kontratën e shitblerjes. Megjithatë atë ditë nuk kisha asnjë mundësi të vija në Tiranë, në kushtet kur pala shitëse, që ishin gjithsej 8 persona, nuk mund të ishin të disponueshme, i kam thënë motrës time E. T. që të shkonte të firmoste kontratën në mirëbesim. Më pas, në vitin 2010 është bërë shitja e këtij trualli shoqërisë “\*\*\*” dhe se edhe në këtë rast motra ime ka nënshkruar sërish në mirëbesim, për shkak të veprimit të mësipërm. Deklaroj se motra ime nuk ka përfituar asgjë nga kjo pronë. Deklaroj se as kunati im Bardhyl Shehu nuk ka lidhje me këtë pronë”; (ii) kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 13.3.2008, lidhur midis 8 bashkëpronarëve në cilësinë e pronarëve të truallit dhe palëve sipërmarrëse, shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori i saj A. T. dhe shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., përfaqësuar nga administratorët E. M. dhe L. M., me objekt “Vënien në dispozicion nga pala pronare kundrejt sipërmarrësve truallin ku është vendosur ngrehina e përkohshme ekspozita

“\*\*\*” me sip. 5.470 m<sup>2</sup> dhe truallin 3.007 m<sup>2</sup>, për ndërtimin e një godine banimi dhe shërbimi”; (iii) vërtetim lëshuar në datën 29.6.2023 nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (Dhoma Civile), që konfirmon se shtetasi A. T. është në proces gjyqësor për pasurinë e lartpërmendur me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k.

#### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

4.11 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat në përgjigje të barrës së provës – arsyeton se:

4.12 Deklarimet e subjektit dhe pretendimet e tij lidhur me padijeninë e tij për blerjen e kësaj pasurie vijnë në kundërshtim me kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme, nënshkruar mes palëve.

4.13 Në nenin 676 të Kodit Civil parashikohet shprehimisht: *“Kontrata quhet e lidhur kur palët kanë shfaqur në mënyrë të ndërsjellë vullnetin e tyre, duke u marrë vesh për të gjitha kushtet thelbësore të saj. Pra, palët kur lidhin kontratën duhet të merren vesh për kushtet që duhet të përmbahen në kontratë”*.

4.14 Sipas kontratës së nënshkruar, palët kanë rënë dakord për çmimin e sendit dhe mënyrën e pagesës dhe dispozitat e kontratës, që parashikojnë kushtet thelbësore të kontratës, janë imperative, urdhëruese, kanë forcën e ligjit dhe duhet të respektohen nga palët. Kontrata është akti provues, dokument ligjor që provon jo vetëm që fakti juridik ka ndodhur, por edhe që të dhënat e përcaktuara në kontratë për ndodhjen e faktit juridik janë ato të përshkruara nga palët nënshkruese në kontratë.

4.15 Kontrata dhe veprimet e mëpasshme për kalimin e pronësisë së sendit provojnë që ndërmjet palëve ka një marrëdhënie juridike për kalimin e pronësisë së sendit dhe kjo marrëdhënie është konkretizuar në vlerën 45.000.000 lekë, e cila i është paguar shitësve e plotë deri në datën 27.10.2009 dhe se palët me nënshkrimin e kontratës dhe kalimin e pronësisë nuk kanë pasur më asnjë pretendim.

4.16 Trupi gjykues vlerësoi deklaratimet e subjektit për padijeninë e veprimeve noteriale si përpjekje të subjektit të rivlerësimit për të deformuar të vërtetën lidhur me pagesën e kësaj pasurie, në funksion të paraqitjes së të dhënave, të cilat do ta shpëtonin nga situata që lidhej me justifikimin e burimeve të ligjshme të kësaj pasurie të tij, duke u ndodhur në kushtet e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pikës 3 të nenit 61, si dhe të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

4.17 Deklarimet e subjektit për padijeninë e tij për kryerjen e veprimeve noteriale nuk mbështeten nga dokumentacioni ligjor, kontrata e shitjes së kësaj pasurie në vitin 2010 kur subjekti ka nënshkruar kontratën, duke konfirmuar se ka pasur dijeni të plotë të veprimeve ligjore e financiare të kryera nga personi i lidhur me të bashkëshortja e tij, lidhur me transaksionet e shitblerjes së pasurisë dhe vlerave monetare përkatëse.

4.18 Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar të ardhurat të përfituara nga shitja e kësaj pasurie të paluajtshme, të cilat, referuar kontratës së shitjes në rubrikën e të ardhurave të përfituara nga subjekti i rivlerësimit sipas detyrimit të udhëzimit të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklaratimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj.”.

4.19 Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie, trupi gjykues e analizoi këtë mosdeklarim njëkohësisht me aspektet e tjera të transaksionit, sikurse mungesa e gjurmëve dokumentare të këtij transaksioni. Gjithashtu, Komisioni analizoi edhe vlerën provuese të deklaratës noteriale datë 15.7.2023 të shtetasis A. T. dhe, bazuar edhe në qëndrimet që ka

mbajtur Kolegji në çështje të ndryshme, çmoi se megjithëse deklarata nuk është e pavlefshme në kuptim të legjislacionit për noterinë, fuqia e saj provuese në këtë proces nuk është bindëse, pasi është kryer gjatë procesit të rivlerësimit, çka të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit.

4.20 Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me këto të ardhura dhe mosdeklarimit të tyre nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, duke u ndodhur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84.2016.

4.21 Në përmbledhje të sa më sipër, aspektet e rrethanave faktike të cilat iu nënshtruan analizës ligjore nuk sjellin si konkluzion logjik konstatimin e mjaftueshmërisë apo të ligjshmërisë së burimeve të personit të lidhur me subjektin (bashkëshortja) për blerjen e kësaj pasurie të paluajtshme, nën dritën e nenit 32, pika 4.

4.22 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm në kuadër të kërkesave të nenit 32, pika 4 e ligjit, për ligjshmërinë e burimit të krijimit.

4.23 Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të ndodhen në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

4.24 Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës edhe lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie dhe mosdeklarimin e tyre në deklaratën *Vetting*, duke u ndodhur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

4.25 Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie, gjendet në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

4.26 Trupi gjykues çmon të nënvizojë përpjekjen e subjektit të rivlerësimit për të deformuar të vërtetën në funksion të paraqitjes së të dhënave, të cilat do ta shpëtonin atë nga situata që lidhej me justifikimin e burimeve të ligjshme të kësaj pasurie të tij, duke u ndodhur në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

## **5. Depozitë në “Intesa Sanpaolo Bank”, në shumën 3.465.600 lekë**

5.1 Në deklaratën *Vetting*, personi i lidhur me subjektin deklaroi: *“Depozitë në Intesa Sanpaolo Bank në shumën 3.465.600 lekë, ku një pjesë e kësaj shume, dhe konkretisht 3.000.000 lekë është dhuruar nga vëllai im A. T., biznesmen, administrator i shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. (\*\*\*) me nr. identifikimi NIPT \*\*\* (kjo shumë është dhënë fillimisht për ta derdhur në NBG si garanci për në Ambasadë për të nxjerrë një vizë greke për kurimin e djalit në Greqi e më pas nuk ma ka kërkuar shumën në fjalë, pra ma ka dhuruar këtë shumë. Dokumenti justifikues – statementi i nxjerrë nga Emporiki Bank Albania, ku vëllai im A. T. më ka kaluar nga llogaria e tij në llogarinë time shumën në fjalë. Më pas, kësaj shume i është shtuar edhe një shumë prej 9.780 euro dhe 1.220.000 lekë, të dhënë nga mamaja ime dhe babai dhe bashkë me 3.000.000 lekët e dhuruara nga vëllai janë futur nga ana ime në NBG, me qëllim interesin e lartë që kishte kjo bankë. Më pas, në vitin 2015 gjithë shuma prej 5.631.186 lekësh është tërhequr për shkak të krizës greke dhe frikës së falimentit të Bankës Greke. Më pas, nga kjo shumë, 5.000.000 lekë i është dhënë prindërve të mi për t’i përdorur për probleme shëndetësore/operacione dhe shuma prej 635.000 lekësh është mbajtur për pagesa për shkollën e djalit. Në maj të vitit 2016 prindërit e mi më kanë kthyer shumën prej 3.500.000 lekësh dhe 8.500 USD, të cilat janë depozituar në Intesa Sanpaolo Bank. Dokumenti justifikues – statementi i lëshuar nga banka dhe vërtetimi i lëshuar nga shoqëria “\*\*\*”. Shuma 3.465.000 lekë, zotëron 100%”.*

5.2 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) pozicioni i klientit E. Sh. në ISP Bank, për gjendjen në llogari rrjedhëse në shumën 3.465.600 lekë, në datën 24.1.2017; (ii) nxjerrje llogarie e E. Sh.t në Emporiki Bank, për periudhën 1.1.2006 – 1.1.2007, në të cilën evidentohet

kreditimi i shumës 3.000.000 lekë nga shtetasi A. T. në datën 15.6.2006; (iii) nxjerrje llogarie e shtetases E. Sh. në NBG Bank, e datës 17.3.2016, sipas së cilës në datën 26.4.2015 transferohet në llogari shuma 5.651.635 lekë, e përfituar nga këmbimi me euro, shumë me të cilën në datën 4.5.2015 çelet depozitë. Në datën 8.7.2015 tërhiqet me *cash*; (iv) nxjerrje llogarie E. Sh. në ISP Bank, periudha 1.1.2016 – 24.1.2017, me gjendje 3.465.600 lekë. Në datën 13.5.2016 evidentohet depozitimi *cash* i shumës 3.500.000 lekë, me përshkrimin “Kursime, tërhequr nga NBG, viti 2015”.

5.3 Në DPV-në e vitit 2007, subjekti deklaron: “3.000.000 lekë nga kunati A. T., biznesmen, administrator i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. (\*\*\*\*) me nr. identifikimi NIPT \*\*\*, për ta derdhur në NBG si garanci për në Ambasadë për të nxjerrë një vizë greke për kurimin e djalit në Greqi”. Në po të njëjtën DPV, subjekti deklaron: “2.400 dollarë + 4.000 euro + 200.000 lekë dhuruar nga e ëma e bashkëshortes sime në Tirana Bank”. Ndërsa personi i lidhur me subjektin, në DPV-në e vitit 2007 deklaron: “3.000.000 lekë nga vëllai im A. T., biznesmen, administrator i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. (\*\*\*\*), me nr. identifikimi NIPT \*\*\*. Në shkurt 2006 Emporiki Bank si garanci për në Ambasadë për të nxjerrë një vizë greke për kurimin e djalit në Greqi; 3.380 euro + 840.556 lekë + 180.000 lekë + 2.400 euro + 4.000 euro + 200.000 lekë, dhuruar nga mamaja në mars 2006, tetor 2006 dhe shkurt 2007 tek Banka Amerikane dhe Tirana Bank”. Në DPV-në e vitit 2013 para fillimit të detyrës dhe në DPV-në e vitit 2014 subjekti dhe personi i lidhur nuk e kanë deklaruar këtë depozitë. Në DPV-në e vitit 2015, personi i lidhur me subjektin deklaron: “Në datën 8 korrik 2015 tërheqje nga NBG Bank 5.651.635 lekë dhe i kam dhënë mamasë time F. T. 5.000.000,00 lekë në formë huaje, pa ndonjë interes, për t’i përdorur për problemet e saj shëndetësore pa ndonjë deklaratë në mirëbesim për t’i kthyer në vitin 2016, ndërsa 635.000 janë mbajtur për të bërë pagesa të ndryshme të shkollës së djalit dhe shpenzime të tjera familjare”.

5.4 Intesa Sanpaolo Bank, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.7.2017, konfirmon llogari me gjendje 3.465.600 lekë në emër të shtetases E. Sh., për fundvitet 2015 dhe 2016.

5.5 Në pyetësin standard, subjekti ka deklaruar: “Bashkëshortja ka marrë një shumë 3.000.000 lekë, dhuruar nga vëllai i saj A. T.. Kjo shumë është kaluar nga llogaria e tij në llogarinë e bashkëshortes në Emporiki Bank, si garanci në Ambasadë për vizë për kurimin e djalit në Greqi dhe më pas këtë shumë na e ka dhuruar”.

5.6 Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 23.6.2016, subjekti i rivlerësimit, i pyetur në lidhje me mundësinë financiare të kunatit, ka deklaruar: “Kunati e ka pasur dhe e ka aftësinë financiare për dhënie likuiditetesh, pasi këtë gjë ka bërë qysh kur jam martuar me motrën e tij. Që në kohën e fejesës kunati ka bërë vazhdimisht pagesa, ose më saktë i ka dhënë gruas time për shpenzime familjare, për lëvizje jashtë shtetit, për probleme shëndetësore të djalit tim dhe nipit të tij. Për sa i përket aftësisë financiare dua të sqaroj se ai ka biznese në Tiranë dhe në rrethe të tjera të vendit. Ka qenë nja nga aksionerët së bashku me aksionerë të tjerë shqiptarë dhe të huaj, në kompaninë e nxjerrjes së naftës që operonte në zonën Vlorë-Fier me emrin “\*\*\*\*”. Sa i takon shumës, është tërhequr nga bashkëshortja dhe likuiditeti është mbajtur në shtëpinë e vjehrrës. Ndërsa në lidhje me shumën e dhuruara nga nëna, subjekti ka deklaruar se “Në vitet 2006 – 2007 nëna i ka dhuruar bashkëshortes likuiditetet e mësipërme për t’i depozituar në bankë dhe për t’i përdorur për nevojat e saj dhe të prindërve. Në vitet 2006 – 2007 gjendja shëndetësore e vjehrrës është përkeqësuar dhe, për këtë shkak, ajo ka bërë ndërhyrje kirurgjikale të rëndë në Ankara të Turqisë. Në atë kohë i ka dhënë bashkëshortes këtë likuiditet për ta pasur. Në deklaratën noteriale të lëshuar nga prindërit është përmendur si fakt ndihma që prindërit kanë dhënë dhe japin në vazhdimësi, si dhe kam paraqitur dy kontrata qiraje”.

5.7 Ndërsa në pyetësin nr. 2, subjekti i rivlerësimit, i pyetur në lidhje me mosdeklarimin e shumës prej rreth 5.1 milionë lekësh, të disponuar nga bashkëshortja në llogarinë në NBG, para fillimit të detyrës, si dhe në lidhje me burimin e të ardhurave për krijimin e kësaj shume, ka deklaruar: “Shuma prej 5.100.000 është harruar të deklarohet në DIP-në para fillimit të

detyrës, por theksoj se në vitin 2014 është deklaruar interesi nga kjo depozitë dhe është deklaruar edhe në DPV-në e vitit 2015, ku është bërë tërheqja e kësaj shume nga NBG. Sa i përket ecurisë së kësaj shume, deri më 8.7.2015 në NBG dhe pas tërheqjes nga kjo bankë, për shkak të frikës së krizës greke, janë depozituar në Intesa Sanpaolo Bank në datën 13.6.2016 dhe që atëherë nuk janë lëvizur nga kjo bankë. Burimi i shumës prej 5.100.000 lekësh përbëhet nga shuma e dhuruar nga vëllai i bashkëshortes në Emporiki Bank dhe kursimet e prindërve të bashkëshortes”.

5.8 Referuar shpjegimeve të subjektit, shuma 3.000.000 lekë, dhuruar nga vëllai i bashkëshortes së subjektit në vitin 2006, është tërhequr në vitin 2009 dhe nuk është deklaruar si e ruajtur në deklaratën pas largimit nga detyra në vitin 2009 dhe as në deklaratën para marrjes së detyrës në vitin 2013 – nuk mund të përdoret si burim i krijimit të depozitës në deklaratën Vetting.

5.9 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se: (i) subjekti nuk provon burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj depozite, të deklaruar në deklaratën Vetting; (ii) deklaramet e tij lidhur me burimin e krijimit nuk mbështeten nga deklaramet periodike vjetore; (iii) subjekti ndodhet në situatën e parashikuar nga neni D i Aneksit të Kushtetutës lidhur me saktësinë dhe plotësinë e deklaramet të tij dhe paraqitjen në mënyrë të pasaktë të kësaj pasurie në pronësi të tij.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

5.10 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ka sqaruar: “Depozita në Intesa Sanpaolo Bank, në shumën 3.465.600 lekë, ku një pjesë e kësaj shume, dhe konkretisht 3.000.000 lekë, është dhuruar nga vëllai i bashkëshortes A. T., biznesmen, administrator i shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. (\*\*\*) me nr. identifikimi NIPT \*\*\*. Kjo shumë është kaluar nga llogaria e kumatit tim në llogarinë e bashkëshortes time në Emporiki Bank, si garanci për në Ambasadë për të nxjerrë një vizë greke për kurimin e djalit në Greqi e më pas vëllai i bashkëshortes nuk ma ka kërkuar shumën në fjalë, pra ma ka dhuruar këtë shumë. Në lidhje me mundësinë financiare të kumatit, deklaroj se ai e ka pasur dhe e ka aftësinë financiare për dhënie likuiditetesh, pasi këtë gjë ka bërë qysh kur jam martuar me motrën e tij. Që në kohën e fejesës kunati ka bërë vazhdimisht pagesa, ose më saktë i ka dhënë gruas sime për shpenzime familjare, për lëvizje jashtë shtetit, për probleme shëndetësore të djalit tim, njëkohësisht nipit të tij.

Më pas, kësaj shume i është shtuar edhe një shumë prej 9.780 euro dhe 1.220.000 lekësh, të dhënë nga mamaja e bashkëshortes dhe babai dhe bashkë me 3.000.000 lekët e dhuruara nga vëllai i saj janë depozituar nga bashkëshortja ime në NBG, me qëllim për të përfutur nga interesi i lartë që kishte kjo bankë.

Lidhur me gjetjet e Komisionit se shuma prej 3.000.000 lekësh, që është tërhequr në vitin 2009 dhe nuk është deklaruar si gjendje cash në deklaratën pas largimit nga detyra, në vitin 2009 dhe as në deklaratën para marrjes së detyrës, në vitin 2013, duke aluduar se nuk provohet burimi i ligjshëm, në deklaratën periodike të vitit 2013 bashkëshortja ime ka deklaruar vetëm shumën prej 10.000 USD, të dhënë nga prindërit e saj në vitin 2012, ndërsa shuma tjetër që është depozituar në vitin 2011 nga bashkëshortja ime është harruar të deklarohet, por nuk ka pasur asnjë qëllim fshehjeje të kësaj shume apo qëllim tjetër. Në vijim të këtij arsytimi vjen edhe fakti se në deklaratën periodike të vitit 2014 është deklaruar interesi nga llogaria e shumës së depozituar në NBG (151.506 lekë), çka nënkupton se qëllimi i mosdeklarimit nuk ka qenë fshehja a mosdeklarimi i shumës. Ndërkohë që në deklaratën periodike të vitit 2015 kam deklaruar tërheqjen nga bashkëshortja në datën 8.7.2015, të shumës 5.651.635,00. Po ashtu, po në këtë DIP është deklaruar edhe dhënia e shumës 5.000.000,00 lekë mamasë së bashkëshortes, që është pjesë e shumës së tërhequr sa sipër, për shpenzime për probleme shëndetësore. Në deklaratën e vitit 2016, ndryshe nga ç’pretendohet në raport, është deklaruar

se mamaja e bashkëshortes i ka kthyer kësaj të fundit shumën prej 3.500.000 lekësh dhe 8.500 USD dhe kjo shumë po këtë vit është depozituar në Intesa Sanpaolo Bank në vitin 2016.

Sa i takon shumës, është tërhequr nga bashkëshortja dhe likuiditeti është mbajtur në shtëpinë e vjehrrës. Ndërsa në lidhje me shumën e dhuruara nga nëna e bashkëshortes, deklaroj se në vitet 2006 – 2007 nëna e saj i ka dhuruar bashkëshortes likuiditetet e mësipërme për t'i depozituar në bankë dhe për t'i përdorur për nevojat e saj dhe të prindërve. Në vitet 2006 – 2007 gjendja shëndetësore e vjehrrës është përkeqësuar dhe për këtë shkak ajo ka bërë ndërhyrje kirurgjikale të rëndë në Ankara të Turqisë. Në atë kohë i ka dhënë bashkëshortes këtë likuiditet si “nëna të bijës”, për ta pasur gjendje.

Në deklaratën noteriale të lëshuar nga prindërit e saj është përmendur si fakt ndihma që prindërit kanë dhënë dhe japin në vazhdimësi, ku janë paraqitur në deklaratën Vetting edhe dy kontrata qiraje që kemi mundur të sigurojmë, të dyqaneve të babait të saj S. T., që ka dhënë ambiente me qira (dyqane) në rrugën “\*\*\*”, në afërsi të banesës së tij (kontrata nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.4.1997 dhe kontrata nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 15.4.1997).

Po ashtu, për këtë fakt i kemi bërë edhe kërkesë DRT-së Tiranë për të konfirmuar të dhëna për bizneset e familjes së prindërve të bashkëshortes në periudhën 1991 – 2001, dyqane në anë të bulevardit “\*\*\*”, afër \*\*\* dhe pikë karburanti në këtë vend, por akoma nuk kemi marrë ndonjë përgjigje.

Kjo edhe për shkak të kohës së shkurtër (bashkëlidhur ju dërgojmë një kopje të kërkesës dhe formularin “lajmërim marrje” të postës, ku konfirmohet se kërkesa është marrë nga institucioni). Deklaroj gjithashtu se bashkëshortja ime ka qenë shumë e lidhur me prindërit e saj, të cilët i kanë besuar dhe i besojnë çdo gjë dhe e kanë pasur dhe e kanë pranë në çdo moment kur kanë nevojë dhe ka menaxhuar pothuajse të gjitha shpenzimet për nevojat dhe problemet që ata kanë pasur, sidomos për çështje të shëndetit, kjo ka qenë edhe arsyeja që bashkëshortja ime ka bërë këto lëvizje të tilla, të shumave përshkruar sa sipër”.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

5.12 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar Vetting; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, propësimet dhe provat në përgjigje të barrës së provës – arsyeton se:

5.13 Referuar deklaratimeve periodike të subjektit, shuma 3.000.000 lekë e dhuruar nga kunati në vitin 2006 dhe më pas tërhequr në vitin 2009, nuk është deklaruar si gjendje cash në deklaratën pas largimit nga detyra dhe as në deklaratën para marrjes së detyrës në vitin 2013 – ndaj nuk mund të ketë shërbyer si burim për krijimin e depozitës në deklaratën Vetting.

5.14 Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e subjektit, vlerësoi se bazuar në pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D të Aneksit të Kushtetutës për kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaratimit dhe burimit të ligjshëm të pasurisë, i vlerëson ato të pambështetura nga deklaratat periodike të cilat kanë vlerën e provës në procesin e rivlerësimit.

5.15 Detyrimi ligjor i subjektit të rivlerësimit për të deklaruar pasuritë dhe gjendjen cash ka lindur që nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, përcaktimet e të cilit kanë qenë të qarta në këtë drejtim, lidhur me deklarimin e çdo pasurie, të paluajtshme, të luajtshme, përfshirë edhe likuiditetet në formën e gjendjes cash, si dhe shtesat dhe ndryshimet në to.

5.16 Marrja në konsideratë e likuiditetit sipas pretendimit të subjektit është një argument që nuk mbështetet në ligjin nr. 9043/2003, të ndryshuar, i cili ka parashikuar në mënyrë të qartë detyrimin e çdo subjekti rivlerësimi për të deklaruar çdo shtesë e pakësim të pasurisë në çdo

formë që ajo ndodh përgjatë një viti periodik. Për rrjedhojë trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar depozitën në “Intesa Sanpaolo Bank”, në shumën 3.465.600 lekë sipas parashikimeve të gërmave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

### **KONKLuzion Përfundimtar**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara dhe provat e parashtruara nga subjekti arrin në përfundimin se:

- a) Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij, në referim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.
- b) Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur/paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim apo përdorim të tij, në referim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.
- c) Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë.
- d) Bazuar në paragrafin 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e cënimit të besimit të publikut te drejtësia.

### **Për këto arsye,**

Trupi gjykues, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet A, Ç, D dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në pikat 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Bardhyl Shehu, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.
2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 10.8.2023.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Pamela QIRKO**  
Kryesuese

**Xhensila PINE**  
Relatore

**Alma FASKAJ**  
Anëtare

*Sekretare gjyqësore*  
Jonida Vrana